



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2019 regjistër (JR)
Datë 12.02.2019

Nr. 1 i vendimit
Datë 15.01.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.01.2020, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Admir Belishta, gjyqtar, me detyrë kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 62 dhe 63 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Admir Belishta, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Admir Belishta (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, pasi ka mosdeklarim të pasurisë;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit.

1.3 KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar tri dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 93, datë 21.12.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 93, datë 21.12.2018, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtar dhe kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ky vendim

është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej tri kritereve të rivlerësimit, si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë.*
- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarin e pasurisë së tij ndër vite.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e pasurisë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.*
- *Subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, me kryerjen e një ndërtimi të paligjshëm në vitin 2013, kur në të njëjtën kohë, për të njëjtin veprim ka mbajtur qëndrim tjetër në pozicionin e gjyqtarit, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.*
- *Subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë me të ardhura shpenzimet e kryera prej tij në vitet 2009, 2011, 2012, 2013, 2014.*

3.2 Për kontrollin e figurës: *Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale: *Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, pasi shqyrtoi raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLD-ja, shqyrtoi denoncimet nga publiku, si dhe katër dosjet gjyqësore të kërkuara, bazuar në pikën 4 të nenit 41, të ligjit 84/2016, Komisioni çmon se, përtej vlerësimit pozitiv nga KLD-ja si institucion ndihmës, të metat e konstatuara në shqyrtimin e katër dosjeve gjyqësore reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, konstatime këto edhe të gjykatave më të larta.*

4. Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se:

- *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;*
- *subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës.*

Duke kryer një vlerësim tërësor të të tri kritereve, mbi të cilat mbështetet procesi i rivlerësimit të gjyqtarit, Komisioni konkludon, gjithashtu, se subjekti Admir Belishta, me veprimet/mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 04.02.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 93/1, datë 04.02.2019.
6. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në shkaqet si më poshtë.

A. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

6.1 Komisioni ka arritur në përfundime të pabazuara në lidhje me mungesën e mundësive financiare të subjektit për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 107 m² në Korçë, në vitin 2009. Subjekti ka disponuar mjetet e nevojshme financiare për blerjen e apartamentit.

6.2 Për pasurinë shtëpi, me sipërfaqe ndërtimi prej 62,4 m², të ndërtuar nga subjekti në truallin e tij në fshatin {***} të Korçës, konstatimet e Komisionit në vendim janë të pabazuara dhe në keqinterpretim të kuadrit ligjor në fuqi, pasi të gjitha veprimet e ndjekura nga subjekti dhe familjarët e tij janë kryer në përputhje me ligjin dhe janë produkt i vendimmarrjeve administrative të organeve shtetërore. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është plotësisht i ligjshëm dhe kjo ligjshmëri mund të kontestohet vetëm nga subjekte pretenduese dhe vetëm para një institucioni gjyqësor, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj). Subjekti nuk ka kryer deklaram të rremë, sepse në rastin konkret mungon dashja si element subjektiv i shoqëruar me qëllimin e posaçëm të përfitimit. Refuzimi i Komisionit për kryerjen e këqyrjes në vend, si dhe të një ekspertimi vlerësues të objektit, i kanë cenuar subjektit një të drejtë kushtetuese, të sanksionuar edhe në aktet ndërkombëtare, në funksion të një procesi të rregullt ligjor.

6.3 Për pasurinë automjet “Mercedes Benz” vit prodhimi 2002, në pronësi të subjektit, konkluzionet e Komisionit janë të paargumentuara dhe kontradiktore. Komisioni, nga njëra anë, nuk ka vlerësuar faktet e deklaruara nga vetë shitësi me deklaratë noteriale, ndërsa, nga ana tjetër, ka refuzuar kërkesën e subjektit për ta marrë në cilësinë e dëshmitarit, duke cenuar të drejtën e tij për të paraqitur prova. Komisioni nuk ka argumentuar në vendim pse nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet juridiko-ekonomike të subjektit në lidhje me mundësinë e tij financiare për blerjen e automjetit.

6.4 Mosdeklarimi fillestar i pasurisë së bashkëshortes së subjektit në familjen e saj para martese ka qenë thjesht një pakujdesi, e pashoqëruar me ndonjë motiv tjetër. Subjekti i ka provuar Komisionit me dokumentacion ligjor se as bashkëshortja e as familjarët e saj nuk e kanë përdorur këtë pasuri dhe nuk kanë nxjerrë të ardhura prej saj. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se bashkëshortja e subjektit duhet të kishte deklaruar këtë pronë, nuk është i drejtë.

6.5 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2011-2014 është e paargumentuar dhe e pabazuar në prova, duke konkluduar në mënyrë të pasaktë për pamjaftueshmëri të burimeve financiare për të përballuar shpenzimet e kryera nga subjekti për këto vite. Komisioni nuk ka argumentuar në vendim arsyet pse nuk i ka marrë parasysh shpjegimet e subjektit, duke cenuar kështu rregullat e parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me arsyetimin e plotë dhe të detajuar të vendimit.

B. Për kriterin e kontrollit të figurës

6.6 Subjekti i rivlerësimit është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNj-së, pasi i është shkelur e drejta e aksesit të të gjitha aktet e provat e mbledhura për të, si dhe për t’u ballafaquar me to, për pasojë i është mohuar edhe e drejta e realizimit të një mbrojtjeje objektive dhe efektive.

6.7 Konkluzioni i Komisionit mbi papërshtatshmërinë e subjektit në ushtrimin e detyrës është i pabazuar dhe i paargumetuar, sepse gjatë gjithë procesit të hetimit dhe në seancë dëgjimore nuk iu relatua asnjë fakt, rrethanë, indicie, dokumentacion apo provë konkrete, mbi të cilën bazohet ky konkluzion.

C. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

6.8 Konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, abuziv dhe tendencioz, pasi ka analizuar vetëm katër vendime të dhëna nga subjekti në vite të ndryshme, ndër të cilat vetëm dy janë cenuar. Komisioni nuk mund të shqyrtojë çdo lloj vendimmarrjeje, duke kontestuar çdo lloj arsytimi, qoftë kur vendimi është cenuar, lënë në fuqi apo kur ndaj vendimit nuk ka pasur fare ankim, duke u kthyer në një shkallë të posaçme gjykimi, jashtë kompetencës së vet kushtetuese dhe ligjore. Subjekti, për dy vendime, është vlerësuar negativisht dy herë, duke qenë se këto vendime janë përdorur nga Komisioni për vlerësimin e figurës dhe për vlerësimin e aftësive profesionale, në kundërshtim me të gjitha parimet e aktet ndërkombëtare.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012 i ndryshuar”). Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve që ai i ka bashkëlidhur ankimit, të cilat janë:
 1. vërtetim i Bashkisë Maliq nr. {***} prot., datë 22.01.2019, sipas të cilit z. A. B. punon me detyrë teknik pyjesh, me pagë mujore neto 33083 lekë;
 2. vërtetim i Bashkisë Maliq nr. {***} prot., datë 22.01.2019, sipas të cilit z. A. B. merr shpërblim si kryeplak i fshatit {***} një pagë mujore neto prej 6375 lekësh;
 3. vërtetim i ISSh, Drejtoria Rajonale Korçë, nr. {***} prot., datë 25.01.2019, sipas të cilit znj. M. B. merr pension pleqërie në masën 15.148 lekë;
 4. vërtetim i AKU, Korçë, nr. {***} prot., datë 23.01.2019, sipas të cilit z. B. B. merr pagë mujore neto 54200 lekë;
 5. vërtetim i DAR, Korçë, datë 22.01.2019, sipas të cilit znj. E. B. merr pagë mujore neto 43506 lekë;
 6. kërkesë e subjektit të rivlerësimit Admir Belishta, datë 28.12.2018, drejtuar DSIK-së me lëndë “Kërkim dokumentacioni”, si dhe kartelat postare të dërgimit të kësaj kërkesë nëpërmjet shërbimit postar;
 7. shkresë nr. {***} prot., datë 03.01.2019, e DSIK-së drejtuar z. Admir Belishta, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, e cila ka bashkëlidhur:
 - 7/1. shkresë e DSIK-së me nr. {***} prot., datë 07.02.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***} prot., datë 25.04.2018, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta”, drejtuar Komisionit;

7/2. shkresë e DSIK-së me nr. {***} prot., datë 29.10.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***} prot., datë 30.10.2018, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta”, drejtuar Komisionit;

7/3. shkresë e DSIK-së me nr. {***} prot., datë 18.12.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***} prot., datë 21.12.2018, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta”, drejtuar Komisionit;

8. kërkesë e subjektit të rivlerësimit Admir Belishta, datë 14.01.2019, drejtuar DSIK-së me lëndë “Kërkim dokumentacioni”, si dhe kartelat postare të dërgimit të kësaj kërkesë nëpërmjet shërbimit postar;
 9. shkresë nr. {***} prot., datë 18.01.2019, e DSIK-së drejtuar z. Admir Belishta, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”;
 10. procesverbal kallëzimi shtesë nr. {***} prot., datë 22.10.2007, me kallëzuese I. D., drejtuar Prokurorisë së Rrethit Korçë dhe Prokurorisë së Rrethit Pogradec;
 11. procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, i Prokurorisë së Rrethit Pogradec, datë 09.11.2007 – deklarimet e shtetasës I. D.;
 12. procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, i Prokurorisë së Rrethit Pogradec, datë 09.11.2007 – deklarimet e shtetasit M. D.;
 13. procesverbal mbi kallëzimin e krimit, datë 10.10.2007, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, me kallëzues M. D.;
 14. procesverbal mbi kallëzimin e krimit, datë 10.10.2007, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, me kallëzuese I. D.;
 15. letër ankese e shtetasve M. D. e I. D., drejtuar Gjykatës së Rrethit Pogradec, Prokurorisë së Rrethit Pogradec, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë të Drejtësisë, Institutit të Mjekësisë Ligjore, Presidentit të Republikës;
 16. autorizim nr. {***} prot., datë 06.05.2009, nënshkruar nga subjekti në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
8. Trupi gjykues, analizën për pranueshmërinë për shqyrtim ose jo të këtyre provave, e mbështeti në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj, si edhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon: Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarrtshëm; d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.*
9. Në analizë të parashikimeve ligjore të cituara më sipër, trupi gjykues vendosi të mos i pranojë në cilësinë e provës aktet e paraqitura bashkëlidhur ankimit, pasi subjekti në ankim nuk ka provuar se ishte në pamundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ, siç kërkon zbatimi i nenit 47 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Megjithatë, edhe në prezumimin në favor të subjektit, se këto akte do të ishin në plotësim të kriterëve ligjore të sipërcituara, ato u çmuan si të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “c” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

Arsyetimi i detajuar në lidhje me këtë konkluzion, gjendet i shtrirë në trajtimin e atyre shkaqeve të ankimit me të cilat lidhet qëllimi i paraqitjes së këtyre akteve nga subjekti.

10. Subjekti, pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, më datë 07.01.2019, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet me shkrim 5 ditë para seancës gjyqësore¹, bashkëlidhur të cilave ka paraqitur akte shkresore. Këto akte të paraqitura për herë të parë nga subjekti, trupi gjykues vendosi të mos i pranojë, pasi vlerësoi se bazuar në nenet 47 e 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në këtë fazë të procesit palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja.
11. Gjithashtu, nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cili parashikon rastet kur një gjykim administrativ në gjykatën e apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike.
12. Për të gjitha arsyet e analizuara si më sipër, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka konkluduar në mënyrë të pabazuar në lidhje me mungesën e mundësive financiare të subjektit për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 107 m² në Korçë, në vitin 2009, pasi bazuar në të ardhurat dhe kursimet e deklaruara nga viti 2004-2009, si dhe në huan e marrë dhe të deklaruar në vitin 2009, ai ka disponuar mjetet e nevojshme financiare për blerjen e apartamentit, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit², subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shkelur detyrimin kushtetues dhe ligjor sepse, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në nenet 30, 31, pika 1, 32, pika 1 dhe në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, ai ka detyrimin të deklarojë pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, si dhe të paraqesë të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Ligji nr. 84/2016 ka qenë i qartë në kërkesën për deklarimin e burimit të krijimit të pasurive dhe po kështu ka qenë edhe udhëzimi i datës 10.10.2016 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, për mënyrën e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Në këtë kuptim, për shkak të mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 107 m², trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.*
14. Trupi gjykues, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstaton se sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2009, të lidhur mes subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit dhe z. T. C. në cilësinë e shitësit, çmimi i shitblerjes së

¹ Parashtrimet me shkrim 5 ditë para seancës gjyqësore janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit më datë 07.01.2020 dhe janë protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 07.01.2020.

² Dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, në datën 30.01.2017.

apartamentit me sipërfaqe 107 m², është 4.900.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ³, subjekti ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer kursimet nga paga, honoraret, mësimdhënia, botimet, të akumuluar ndër vite; pjesëmarrja në mbledhjet e bordit të buxhetit gjyqësor; të ardhurat si rezultat i ndarjes nga trangu familjar; si dhe një pjesë nga huaja e marrë nga shtetasi M. Z.

Në ankim, subjekti ka ngritur një sërë pretendimesh në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni për të vlerësuar mundësinë e tij për të blerë me burime financiare të ligjshme pasurinë apartament me sipërfaqe 107 m² në Korçë, si më poshtë.

15. Subjekti pretendon se për vitin 2009 të ardhurat e tij janë në vlerën 1.551.031 lekë, shumë të cilën e ka deklaruar edhe në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2009, dhe jo në vlerën 980.262 lekë sa ka përlllogaritur Komisioni. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues verifikoi të ardhurat e subjektit, duke krahasuar informacionin e përcjellë nga vërtetimet e institucioneve përkatëse⁴ me informacionin e përcjellë nga Banka Raiffeisen, Banka Credins dhe Banka Union, në lidhje me shpërblimet, honoraret dhe përfitimet e tjera nga botime dhe trajnime. Në ndjekje të veprimeve të derdhjes së pagave dhe honorareve në llogaritë rrjedhëse të subjektit, trupi gjykues konstaton se shumata e të ardhurave (paga, honorare, interesa) të kaluara nëpërmjet bankave në favor të z. Admir Belishta, për vitin 2009, është në vlerën 1.402.539 lekë. Në këtë vlerë, trupi gjykues nuk konsideroi shumën prej 36.000 lekësh, me përshkrim “dieta”, duke vlerësuar se dieta nuk është e ardhur, por një kompensim për një shpenzim të kryer më parë. Po kështu, nuk u konsideruan edhe dy shumata, 46.980 lekë dhe 17.280 lekë, pasi trupit gjykues i rezultoi se ato janë kreditime në llogarinë bankare, të kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues, nga sa më sipër, arrin në konkluzionin se vlera 1.402.539 lekë, është vlera e të ardhurave të subjektit që duhet të ishte konsideruar nga Komisioni në analizën financiare dhe kjo është vlera që do të mbahet në konsideratë prej tij në vlerësimin e mundësive të subjektit për të krijuar pasurinë objekt analize.
16. Subjekti pretendon se Komisioni ka llogaritur pa të drejtë si shpenzim shumën 400.000 lekë, e cila përbënte një pjesë të shumës totale prej 1.000.000 lekësh të huas së marrë nga z. M. Z., pasi kjo shumë nuk duhej llogaritur as si kredit e as si debit, sepse ajo si u mor, u kthye, dhe ai përdori vetëm pjesën tjetër prej 600.000 lekësh. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se subjekti në cilësinë e huamarrësit dhe z. M. Z. në cilësinë e huadhënësit kanë lidhur një kontratë huaje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.09.2009, për vlerën 1.000.000 lekë, me afat 2-vjeçar, pa interes. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2009⁵, në zërin shpenzime është vendosur vlera 400.000 lekë, por në zërin detyrime është vendosur vlera 1.000.000 lekë. Trupi gjykues vlerëson se evidentimi i të dyja vlerave në analizën e Komisionit ka për qëllim të pasqyrojë qartësisht veprimet e kryera nga subjekti me shumën e marrë hua dhe ky pasqyrim është në përputhje me kërkesat e kontabilitetit për pasqyrimin e veprimeve

³ Në deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, dërguar në Komision më datë 12.09.2018.

⁴ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 24.01.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për të ardhurat nga paga dhe shpërblime, për z. Admir Belishta, për periudhën nëntor 2003 – mars 2009, vërtetimit nr. {***} prot., datë 13.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, për të ardhurat e z. Admir Belishta, për periudhën 2001–2016; vërtetimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, për të ardhurat e z. Admir Belishta, si anëtar i bordit drejtues të ZABGj-së, për periudhën 2008 - 30 shtator 2016; vërtetimit, datë 25.01.2017, të Universitetit {***}, për të ardhurat e z. Admir Belishta si pedagog i jashtëm, për periudhën 2004 – 2012.

⁵ Shih faqen 10 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.

financiare. Pasqyrimi vetëm i vlerës 600.000 lekë, siç pretendon subjekti, nuk do të sillte ndikim në rezultatin e analizës, pasi ai do të ishte i njëjtë.

17. Subjekti pretendon se shpenzimet e udhëtimeve të kryera në vitin 2009, janë llogaritur në mënyrë të pasaktë dhe të paargumentuar nga Komisioni, në shumën 100.134 lekë, pasi gjatë këtij viti, subjekti ka kryer dy udhëtime pune në Francë dhe Gjermani, kurse pesë udhëtime të tjera private, në Maqedoni dhe Greqi, kanë qenë disaorëshe ose njëditore, për pasojë kostot e tyre kanë qenë minimale. Nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se shpenzimet e kryera nga subjekti për udhëtimet disaorëshe nuk janë përfshirë në analizë në zërin e shpenzimeve të udhëtimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për efekt të procesit të rivlerësimit, në kuptim të kërkesave të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.02.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit”, si dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 4.02.2011, të Këshillit të Ministrave”⁶, që të vërtetojë se shpenzimet për udhëtimet në Francë e Gjermani, të pretenduara si udhëtime pune, janë përballuar nga institucione shtetërore vendase, ose nga institucionet e vendit pritës. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit, se këto shpenzime, në vlerën 100.134 lekë, janë kryer nga subjekti, është i drejtë.
- Bashkëlidhur ankimit, subjekti, për të provuar se një udhëtim disaditor jashtë shtetit e ka kryer për arsye pune dhe, për rrjedhojë, shpenzimet nuk duhet të konsideroheshin nga Komisioni si të kryera prej tij, ka paraqitur autorizimin nr. {***} prot., datë 06.05.2009, të nënshkruar nga ai në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilit autorizohet një gjyqtare tjetër e kësaj gjykate të kryejë detyrat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 18 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2018, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh”, meqenëse subjekti, për periudhën 11.05.2009 - 15.05.2009 do të ishte në një vizitë studimore në Francë dhe Gjermani. Këtë akt, subjekti kërkon që Kolegji ta marrë në cilësinë e provës. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i kishte të gjitha mundësitë që ta paraqiste këtë akt gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, pasi është një akt i hershëm, që mban datën 06.05.2009, dhe subjekti në cilësinë e titullarit të institucionit i kishte të gjitha mundësitë e aksesimit të tij. Në analizë të pretendimit tjetër të subjektit, i lidhur me pretendimin e paraqitjes në ankim të aktit që kërkon të merret si provë, se Komisioni nuk e ka pyetur për shpenzimet e udhëtimit të kryera në këtë vit, trupi gjykues konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, njëri nga zërat e analizës financiare të kryer nga Komisioni, është edhe zëri i shpenzimeve të udhëtimit të llogaritura në vlerën 100.134 lekë. Në këto rezultate, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për justifikimin e diferencës së të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2009. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti nuk ka shprehur asnjë kundërshti në lidhje me përlllogaritjet e bëra nga Komisioni në këtë zë. Për këto arsye, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se autorizimi nr. {***} prot., datë 06.05.2009, për sa i përket përmbajtjes së tij, është i panevojshëm dhe tërësisht i papërshtatshëm, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, sepse megjithëse provon në mënyrë jo të drejtpërdrejtë që në periudhën 11.05.2005 - 15.05.2009 subjekti ka qenë

⁶ Në pikat 4 dhe 5 të udhëzimit nr. 22, përcaktohet se njësia përgjegjëse për financën duhet të kërkojë dokumentimin e plotë të shpenzimeve që përballohen nga pritësi dhe është përgjegjëse për financimin e pjesës së mbetur të shpenzimeve. Në vendimin nr. 870, në pikat 8 dhe 9, përcaktohet se punonjësit që dërgohen jashtë vendit dhe kanë kryer shpenzime transporti dhe akomodimi, paguhen nga buxheti vetëm kundrejt dokumenteve përkatëse, sikurse janë biletat e transportit dhe faturat e hotelit.

jashtë shtetit në një vizitë studimore, nuk përmban asnjë të dhënë që të provojë se kjo vizitë studimore ka qenë zyrtare dhe që shpenzimet e kryerjes së saj janë përballuar nga buxheti i institucionit apo organizatorët e aktivitetit, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.02.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit” dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 4.02.2011, të Këshillit të Ministrave” dhe, për këtë arsye, nuk e pranoi në cilësinë e provës në këtë gjykim.

18. Pretendimin e subjektit se Komisioni, në vendim, nuk ka shpjeguar metodologjinë për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi pavarësisht këtij pretendimi, subjekti në ankim ka kundërshtuar vlerën e përlllogaritur nga Komisioni, duke argumentuar se në të janë përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, si edhe ato private, për të cilat ai ka deklaruar se ka qëndruar te të afërmit, duke mos pasur kosto akomodimi apo ushqimi. Subjekti ka qenë i qartë për mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit nga Komisioni, përderisa ka arritur të argumentojë mbi shpenzime të përfshira apo jo në përlllogaritjet për zërin shpenzime udhëtimi.
19. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka llogaritur në mënyrë të drejtë shumën e kursimeve të akumuluarra nga viti 2005 deri në vitin 2008, të përdorura prej tij për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 107 m², pasi nga vlera e kursimeve *cash*, e deklaruar në vite nga subjekti, ka zbritur për çdo vit vlerën 60.000 lekë, si shpenzime qiraje të paguara nga kursimet. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues, nga verifikimi i deklarimeve periodike të pasurisë në vitet 2005-2008, të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, konstaton se në rubrikën “Ndryshimet e interesave private”, subjekti ka deklaruar: “Pakësime për pagimin e qirasë së shtëpisë në shumën 60.000 lekë (12 muaj x 5000 lekë në muaj)”, por nuk është shprehur se ky shpenzim është mbuluar nga kursimet. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se Komisioni, duke iu zbritur kursimeve *cash* të çdo viti shumën 60.000 lekë si pagesë qiraje dhe duke e përlllogaritur këtë shumë edhe në zërin e shpenzimeve, ka llogaritur praktikisht dy herë të njëjtin lloj shpenzimi. Ky qëndrim i Komisionit ka ndikuar drejtpërdrejt në pakësimin e vlerës kumulative të kursimeve *cash*, të cilën e përlllogarit më pas kur analizon aftësinë paguese të subjektit për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 107 m². Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni në analizën financiare, duhet të kishte konsideruar vlerën 3.650.000 lekë si kursime *cash* kumulative, të deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë së vitit 2008. Trupi gjykues, nisur nga fakti se subjekti si burim për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe totale 107 m², ndër të tjera ka deklaruar edhe kursimet e krijuara ndër vite, kreu analizën financiare, duke arritur në konkluzionin se ai ka pasur situatë ekonomike të favorshme, që i ka mundur atij krijimin e kursimeve në vlerën 3.650.000 lekë, e deklaruar në fund të vitit 2008.
20. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni nuk ka përlllogaritur drejt edhe kursimet e krijuara prej tij në vitin 2009. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të këtij pretendimi, konstaton se subjekti në deklaratën e pasurisë së vitit 2009 ka deklaruar kursime *cash* shtesë në vlerën 1.018.860 lekë, e cila përbëhet nga 600.000 lekë kursime si rezultat i kursimeve nga paga dhe 418.860 lekë kursime nga të ardhurat si anëtar bordi në Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, nga mësimdhënia dhe si ekspert. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit përputhet me atë që ai ka deklaruar në deklarinimin periodik, për pasojë Komisioni duhet të kishte konsideruar vlerën 1.018.860 lekë si shtesa në kursimet *cash* të subjektit, të deklaruara në vitin 2009.

21. Trupi gjykues kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e subjektit për të blerë apartamentin me sipërfaqe 107 m² në vlerën 4.900.000 lekë, nga data 01.01.2009 deri në datën 22.09.2009, e cila është data e lidhjes së kontratës për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit⁷. Për këtë arsye, të ardhurat dhe shpenzimet janë përlllogaritur të fragmentarizuara deri në datën 22.09.2009. Mbështetur në arsyetimin e bërë si më sipër, në analizën financiare u konsideruan të ardhurat e subjektit sipas dokumentacionit bankar, kursimet *cash* të deklaruara deri në fund të vitit 2008, si dhe huaja në vlerën 1.000.000 lekë, e marrë nga shtetasi M. Z., ndërsa shpenzimet në vlerën e përlllogaritur nga Komisioni. Si rezultat i analizës financiare, për këtë periudhë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka diferencë pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve në vlerën 550.024 lekë.

Trupi gjykues, periudhën e kryerjes së analizës financiare e shtriu deri më datë 31 dhjetor të vitit 2009, duke vlerësuar kështu edhe mundësinë e subjektit për të mobiluar apartamentin me sipërfaqe 107 m², si dhe për të shlyer një pjesë të huas, në shumën 400.000 lekë. Duke qenë se subjekti në deklaratën e vitit 2009 ka deklaruar: “4. Pakësim i të gjitha kursimeve të krijuara deri tani, si rezultat i blerjes së apartamentit, mobilimit të tij, si dhe shlyerjes së një pjese të huas së marrë. Vlera totale neto e kursimeve të deklaruara në vite – 4.668.860 lekë”, trupi gjykues vlerëson objektivisht këtë deklaram të subjektit, në lidhje me krijimin dhe përdorimin e kursimeve të akumulara *cash*, për sa kohë që, pavarësisht se nuk duhet të kishte deklaruar shtesa në një kohë kur i kishte përdorur ato, subjekti i rivlerësimit ka përshkruar qartë krijimin e kursimeve dhe destinacionin e përdorimit të tyre. Në kushtet kur subjekti ka pranuar se kursimet e akumuluar *cash* janë përdorur gjatë vitit 2009 dhe në këtë vlerë ai ka përfshirë edhe kursimin e krijuar gjatë këtij viti, në vlerën 1.018.860 lekë, trupi gjykues, në analizën financiare nuk e konsideron vlerën e parave *cash* si kursime të krijuara gjatë vitit 2009, pasi kjo vlerë në fakt është produkt i diferencës së të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit gjatë vitit 2009. Si rezultat i analizës financiare, trupi gjykues konstaton se subjekti ka pasur diferencë pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën e analizuar, në vlerën 280.891 lekë.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 107 m² në Korçë, nuk është i drejtë, pasi gjatë gjykimit u provua e kundërta.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i bazuar.

22. *Subjekti ka pretenduar se për pasurinë shtëpi me sipërfaqe ndërtimi prej 62,4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 130,03 m², të ndërtuar në truallin e tij në fshatin {***}, Maliq, Korçë, konstatimet e Komisionit në vendim janë të pabazuara dhe në keqinterpretim të kuadrit ligjor në fuqi, pasi burimi i krijimit të kësaj pasurie është plotësisht i ligjshëm dhe kjo ligjshmëri mund të kontestohet vetëm nga subjekte pretenduese dhe vetëm para një institucioni gjyqësor, sipas nenit 6 të KEDNj-së. Subjekti nuk ka kryer deklaram të rremë, sepse në rastin konkret mungon dashja si element subjektiv i shoqëruar me qëllimin e posaçëm të përfitimit. Refuzimi i Komisionit për kryerjen e këqyrjes në vend, si dhe të një ekspertimi vlerësues të objektit të ndërtuar, i kanë cenuar subjektin një të drejtë kushtetuese, të sanksionuar edhe në aktet ndërkombëtare, në funksion të një procesi të rregullt. Trupi gjykues, nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, konstaton se për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar: Shtëpi e ndodhur në fshatin e lindjes {***}, Bashkia Maliq, mbi pronën e përfituar si anëtar i familjes bujqësore, me sipërfaqe*

⁷ Sipas paragrafit të shtatë të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2009, e lidhur ndërmjet z. T. C. në cilësinë e shitësit dhe z. Admir Belishta në cilësinë e blerësit, çmimi i shitjes së apartamentit prej 4.900.000 lekësh, me sipërfaqe 107 m², është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

të përgjithshme prone 470 m², sipërfaqe ndërtimi (kati përdhe) 62,4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 130,03 m², e legalizuar me lejen nr. {***}, datë 26.12.2014, e regjistruar në ZVRPP Korçë me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}. Shuma e shpenzuar për ndërtim dhe mobilim, gjithsej 2.600.000 lekë. Pjesa takuese 100%. Trupi gjykues vlerëson se subjekti, duke mos deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në kuptim të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e saj, nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, për pasojë është në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me sa parashikon neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

23. Subjekti, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se ai ka kryer deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me mënyrën e përfitimit të truallit prej 470 m², mbi të cilin ka ndërtuar shtëpinë me sipërfaqe prej 62,4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 130,03 m² (në vijim “shtëpia e ndërtuar në fshatin {***}”), me pretendimin se të gjitha veprimet e kryera nga ai dhe familjarët e tij janë në përputhje me ligjin dhe janë produkt i vendimmarrjeve administrative të organeve shtetërore. Ai pretendon, gjithashtu, se në rastin konkret mungon dashja si element subjektiv i shoqëruar me qëllimin e posaçëm të përfitimit, sepse nuk ka pasur qëllim që të deklarojë në mënyrë të rreme një pronë që familja e tij e ka poseduar qetësisht prej gati 40 vjetësh. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ai ka deklaruar se sipërfaqen prej 470 m² e ka përfituar si anëtar i familjes bujqësore dhe jo si rezultat i vendimit të Komunës Libonik, nisur nga fakti se ky truall fillimisht u shënuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit dhe se, më pas, saktësimi i konfigurimit dhe procedura për regjistrimin e tij janë bërë në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, nga institucionet legjitime të këtij shteti, duke mos u kontestuar nga askush. Të njëjtat argumente dhe pretendime, subjekti i ka paraqitur edhe gjatë hetimit administrativ në Komision.
24. Në analizë të këtij pretendimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe në përmbajtjen e akteve të organeve shtetërore të mbledhura nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rrethanat e faktit në lidhje me këtë pasuri, paraqiten si më poshtë.
- a) Sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. {***}, datë s’ka, familjes së z. A. A. B.⁸ në fshatin {***} i jepet në pronësi 11.628 m² tokë arë. Në këtë akt janë evidentuar dhe sipërfaqet: shtëpi 300 m², e përbërë nga 50 m² arë dhe 250 m² truall, dhe në fund të aktit janë evidentuar: sipërfaqe gjithsej 11.878 m², nga të cilat 11.628 m² arë dhe 250 m² truall.
- b) Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë⁹ (në vijim “ZVRPP”) ka informuar se pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, e llojit truall me sipërfaqe 820 m², nga të cilat ndërtesë 78 m², më datë 07.11.2014 është regjistruar në emër të bashkëpronarëve A., M., Admir dhe B. B., me nga ¼ pjesë secili. Kjo pasuri, në periudhën tetor-nëntor 2014, është mbyllur dhe është regjistruar pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 470 m², e regjistruar në emër të z. Admir Belishta dhe pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, e llojit truall me sipërfaqe 350 m², nga të cilat ndërtim 78 m², e regjistruar në emër të A., M. dhe B. B., me nga 1/3 pjesë secili. Sipërfaqja prej 470 m², me kërkesë të pronarit të saj, z. Admir Belishta, është ndarë fillimisht në dy pasuri me nr. {***} dhe {***}, të cilat më pas janë

⁸ Babai i subjektit të rivlerësimit.

⁹ Sipas informacionit të përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2018, shkresën nr. {***}, prot., datë 15.03.2018, shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2018, si dhe shkresën nr. {***} prot., datë 26.09.2018.

bashkuar dhe është hapur pasuria me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, e llojit truall me sipërfaqe 470 m², nga të cilat ndërtim 62,4 m², regjistruar në bazë të lejes së legalizimit nr. {***}, datë 26.12.2014.

c) Për sa i përket sipërfaqes prej 820 m², ZVRPP Korçë informon se për këtë pasuri është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie, vetëm pas hyrjes në fuqi të vendimit të Komunës Libonik nr. {***}, datë 08.09.2014, procedurë kjo e bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 05.09.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre” (në vijim “VKM nr. 608, datë 05.09.2012). Regjistrimi i parë për këtë pasuri në bazë të rreshtit të parë të AMTP-së nr. 21674 dhe librit të ngastrave nuk është konsideruar i rregullt nga ZVRPP Korçë, sepse në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për token”, me akte të marrjes së tokës në pronësi nuk mund të trajtoheshin toka e llojit truall dhe ndërtesa. ZVRPP Korçë thekson se z. A. B. nuk e ka përfutur pronësinë mbi këtë pasuri nëpërmjet AMTP-së, por sipas vendimit të Komunës Libonik nr. {***}, datë 08.09.2014.

ç) Në lidhje me ndryshimet në sipërfaqen truall në kartelën e pasurisë, nga 250 m² truall të evidentuar sipas AMTP-së në 750 m² sipërfaqe pasurie truall plus arë, të regjistruar fillimisht në regjistrin e pasurive të paluajtshme¹⁰, ZVRPP Korçë informon se të dhënat e kartelës aktuale të pasurisë u referohen matjeve faktike në terren, që janë kryer nga kompania që ka zhvilluar procesin e regjistrimit fillestar, i cili sipas shënimeve në kartelën e pasurisë ka përfunduar në datën 10.03.1999 dhe sipërfaqja faktike ka rezultuar më e madhe. Sipas të dhënave të kartelës së pasurisë, trupi gjykues evidenton se në regjistrimin fillestar, i cili sipas shënimeve në kartelën e pasurisë ka përfunduar më datë 10.03.1999, regjimi juridik i sipërfaqes së tokës prej 750 m², e regjistruar në emër të z. A. B. si kryefamiljar i familjes bujqësore, ka qenë 400 m² tokë arë dhe vetëm 350 m² tokë truall funksional i shtëpisë me sipërfaqe 78 m².

d) Bazuar në kërkesën e datës 03.09.2014 të z. A. B. për pajisjen me dokument pronësie për shtëpinë me sipërfaqe 78 m² në fshatin {***}, e ndërtuar para viteve '90, kryetari i Komunës Libonik ka marrë vendimin nr. {***}, datë 08.09.2014¹¹, me objekt “Kalimin në pronësi të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, shtëpi banimi e ndodhur në fshatin {***}, Komuna Lekas, me sipërfaqe të përgjithshme 820 m², nga të cilat sipërfaqe ndërtesë 78 m²”. Ky vendim, në paragrafin kushtuar analizës ligjore të fakteve, shpjegon se sipas vërtetimit të ZVRPP Korçë, pasuria me nr. {***}, ZK {***} është regjistruar në emër të kërkuarit A. A. B., por i mungon akti i fitimit të pronësisë në kuptim të nenit 193 të Kodit Civil. Ndërtesa është bërë para vitit 1991, gjë që provohet nga vërtetimi i lëshuar nga organi i pushtetit vendor dhe nga verifikimi në vend i kryer nga ana e specialistëve të komunës konstatohet se nuk janë bërë shtesa ose ndryshime në strukturën e ndërtesës. Gjithashtu, vendimi shpjegon se referuar planit të rilevimit dhe sipas verifikimeve në vend, konstatohet se pavarësisht se pasuria është regjistruar në ZVRPP Korçë me sipërfaqe totale 750 m², në fakt në terren kjo pasuri është me sipërfaqe 820 m², prandaj në zbatim të pikës 6, shkronja “c” e VKM-së nr. 608, datë 05.09.2012, duhen saktësuar kufijtë e pronës dhe regjistrimi i pasurisë do të bëhet në emër të subjekteve A., M., Admir dhe B. B., sipas gjendjes familjare të datës 01.08.1991. Më tej, vendimi sqaron se planvendosja e pasurisë objekt kërkesë për regjistrim ka qëndruar e afishuar për 45 ditë, periudhë gjatë së cilës nuk pati asnjë kontestim, duke u plotësuar kështu të gjitha kushtet e përcaktuara në VKM-në nr. 608, datë

¹⁰ Në sipërfaqen prej 750 m² përfshihet sipërfaqja prej 350 m² truall, brenda të cilit 78 m² ndërtesë.

¹¹ Paraqitur si provë nga subjekti në përgjigjet e pyetjeve dërguar në Komision më datë 12.09.2018, si edhe nga ZVRPP Korçë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2018.

05.09.2012 dhe, për këto arsye, pasuria me nr. {***}, ZK {***}, me sipërfaqe 820 m², nga të cilat 78 m² ndërtesë, kalon në pronësi të subjekteve A., M., Admir dhe B. B.

Vendimi ka bashkëlidhur planin e rilevimit të pasurisë nr. {***}, ZK {***}, i paraqitur nga z. A. B. bashkëlidhur kërkesës për njohjen e pronësisë së shtëpisë me sipërfaqe 78 m², i përgatitur më datë 01.09.2014 nga një topograf i licencuar, i zgjedhur prej tij. Në këtë plan rilevimi, në gjendjen faktike të pronës pasqyrohet sipërfaqja prej 820 m², në të cilën gjendet vetëm njolla e ndërtesës me sipërfaqe 78 m². Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP Korçë më datë 27.10.2014, me sipërfaqe 820 m² truall, nga të cilat 78 m² ndërtesë, sipas disponimit të vendimit të Komunës Libonik. Trupi gjykues evidenton se kryetari i Komunës Libonik, duke i kaluar në pronësi z. A. B. të gjithë sipërfaqen prej 820 m² si tokë truall, në një kohë kur sipas ZVRPP Korçë në këtë sipërfaqe vetëm 350 m² kanë qenë truall, ndërsa pjesa tjetër prej 400 m² ka qenë tokë arë, ka ndryshuar kategorizimin e tokës për këtë sipërfaqe. Në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”¹², pronarët e tokës dhe poseduesit e tjerë të ligjshëm, si dhe autoritetet shtetërore për mbrojtjen e tokës bujqësore, detyrohen që të sigurojnë qëndrueshmërinë e burimeve të tokës bujqësore, sipas kategorizimit të bërë në regjistrat kadastralë të shtetit. Ndryshimi i tokës bujqësore në kategori të tjera burimesh si tokë urbane etj., bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”¹³. Sipas këtij ligji, ndërtimet dhe çdo ndryshim i kategorive të tokës, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative, ndërsa Kodi Penal në nenin 199 parashikon se “Shpërdorimi i tokës në kundërshtim me destinacionin e saj përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.” Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ndryshimi i kategorizimit të tokës nga tokë bujqësore e regjistruar si e tillë në ZVRPP Korçë, në tokë urbane truall, është bërë në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi të sipërcituar. Nga verifikimi i planvendosjeve të pasqyruara në kartelën e pasurisë me ndryshimet përkatëse, trupi gjykues konstaton se mbi këtë sipërfaqe toke së cilës i ka ndryshuar kategorizimi, shtrihet shtëpia dykatëshe e ndërtuar nga subjekti i rivlerësimit.

dh) Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë në Komision nga ALUIZNI Korçë¹⁴, trupi gjykues konstaton se në aktin “Deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës së ndërtimit pa leje”, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit më datë 17.11.2014 pranë këtij institucioni, ai ka vetëdeklaruar ndërtimin, në vitin 2013, të shtëpisë dykatëshe mbi truallin prej 470 m² në {***}. Ky fakt rezulton edhe nga “Akt Kualifikimi” nr. {***}, datë 24.12.2014, i ALUIZNI-T Korçë, sipas të cilit objekti që legalizohet është identifikuar në imazh satelitor, fotografuar më datë 20.08.2013. Edhe vetë subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit¹⁵, ka deklaruar se ndërtimi i shtëpisë në {***} është përfunduar në vitin 2013.

¹² Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, në nenin 13 të tij parashikon:

“1. Pronarët e tokës dhe poseduesit e tjerë të ligjshëm, si dhe autoritetet shtetërore për mbrojtjen e tokës bujqësore, detyrohen që, në të gjithë madhësinë e sipërfaqes në pronësi, të sigurojnë qëndrueshmërinë e burimeve të tokës bujqësore, sipas kategorizimit të bërë në regjistrat kadastrale të shtetit.

2. Ndryshimi i tokës bujqësore në kategori të tjera burimesh, si në tokë urbane, tokë pyjore, pyll, kullotë, livadh dhe tokë e pafrytshme bëhet sipas përcaktimit në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”.

¹³ Shih nenin 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.

¹⁴ Informacion i përcjellë në Komision me shkresë nr. {***} prot., datë 09.02.2018.

¹⁵ Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, paraqitur nga subjekti në Komision, më datë 14.12.2018.

25. Në analizë të pretendimit të subjektit në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson t'u drejtohet parashikimeve të VKM-së nr. 608, datë 05.09.2012, e cila në pikën 4 përcakton kushtet që duhet të plotësojnë pasuritë e paluajtshme për t'u kaluar në pronësi subjekteve kërkuese. Në shkronjën "b" të kësaj pike parashikohet se *b) Truall funksional duhet të rezultojë fizikisht i lirë dhe i pazënë nga ndërtime pa leje, të cilat janë objekt i ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Madhësia e sipërfaqes së truallit funksional në posedim të përfituesit të jetë ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, "Për urbanistikën"*.

Në analizë të kësaj shtate ligjore dhe zbatimit të saj në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se babai i subjektit të rivlerësimit nuk mund të fitonte pronësinë e sipërfaqes prej 820 m² si truall funksional të shtëpisë 78 m² të ndërtuar para viteve '90, pasi:

a) ky truall nuk rezultonte fizikisht i lirë dhe i pazënë nga ndërtime pa leje, sepse në të ishte ndërtuar në vitin 2013, shtëpia dykatëshe e subjektit të rivlerësimit, siç rezultoi e provuar nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga ALUIZNI dhe nga deklaratimet e vetë subjektit gjatë hetimit administrativ dhe në ankim;

b) për sa i përket madhësisë së sipërfaqes së truallit funksional, sipas bazës ligjore të sipërcituar, ajo duhet të ishte 300 m², madhësi kjo e miratuar me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5747, datë 29.6.1978, "Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve e fshatrave"¹⁶, i cili përbënte dispozitat ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, "Për urbanistikën". Trupi gjykues vëren se madhësia prej 300 m² që mund t'i kalohej në pronësi babait të subjektit të rivlerësimit, sipas VKM-së nr. 608, datë 05.09.2012, korrespondon me sipërfaqen e truallit të regjistruar në regjistrimin e parë në ZVRPP Korçë, si sipërfaqe funksionale e shtëpisë prej 78 m². Sipërfaqja që mund të kishte poseduar familja e subjektit të rivlerësimit, deri para vitit 1993 ishte në madhësinë 300 m², për rrjedhojë, sipërfaqja prej 470 m², tashmë në pronësi të subjektit, në kundërshtim me sa pretendon ai, nuk mund të ishte poseduar ligjërisht, më parë, nga familja e tij. Kriteri i vendosur nga vendimi i Këshillit të Ministrave lidhet me madhësinë e sipërfaqes së truallit funksional të poseduar ligjërisht dhe jo faktikisht nga familja e subjektit.

26. Në funksion të analizës për shqyrtimin e ankimit në lidhje me këtë shkak, trupi gjykues vlerëson të mbështetet edhe në parashikimet e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, sidomos të ndryshimeve të bëra nga ligjvënësi me ligjin nr. 50/2014, datë 15.05.2014, i cili ka hyrë në fuqi më datë 27.06.2014, referuar vitit kur babai i subjektit ka paraqitur kërkesën për kalimin në pronësi të shtëpisë 78 m² dhe truallit funksional të saj, si dhe kur subjekti ka paraqitur aplikimin dhe ka përfituar lejen e legalizimit për shtëpinë e ndërtuar në fshatin {***}. Sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 2 të këtij ligji, fusha e zbatimit të tij shtrihet mbi objektet e ndërtuara pa leje deri më 15.1.2009, si edhe mbi ndërtimet pa leje të ngritura pas kësaj date, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që ato të jenë të ngritura në truall në pronësi të personit posedues të ndërtimit pa leje, si dhe procedura e legalizimit të mos kërkojë kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin. Në kuptim të këtij parashikimi, subjekti nuk mund të kërkonte legalizimin e ndërtimit të shtëpisë së ndërtuar në {***} në vitin 2013, nëse nuk kishte pronësinë e sipërfaqes së tokës mbi të cilën kishte kryer

¹⁶ Sipas nenit 10, paragrafi i katërt i këtij dekreti: "Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore jepet në përdorim një ngastër deri në 200 m², në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit 140 deri në 170 m²."

ndërtimin. Kjo sipërfaqe toke nuk duhet të ishte tokë bujqësore, sepse në mbështetje të parashikimeve të nenit 14, pika 1 e ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”¹⁷, i ndryshuar, ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.

27. Referuar në sa pasqyruar më sipër, trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i së vërtetës nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me mënyrën e përfitimit të pronësisë së sipërfaqes mbi të cilën ka ndërtuar shtëpinë në fshatin {***}, ka qenë një përpjekje e tij për të devijuar kontrollin që do të kryenin organet e rivlerësimit, sepse në vështrim të kërkesave ligjore të VKM-së nr. 608, datë 05.09.2012, ai dhe familja e tij nuk mund të fitonin pronësinë e truallit prej 820 m², pjesë e të cilit ka qenë sipërfaqja prej 470 m² në pronësi të subjektit, ku ky i fundit ka ndërtuar shtëpinë e tij. Kësaj sipërfaqeje, me vendimin e kryetarit të Komunës Libonik iu ndryshua kategorizimi nga “tokë bujqësore” në “truall,” në kundërshtim me parashikimet dhe kompetencat që legjislacioni në fuqi u njëjste organeve të njësisë se qeverisjes vendore. Subjekti ka përdorur në favor të tij faktin se një pjesë e këtij trualli fillimisht është shënuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit. Por ky argument nuk shëron mosvërtetësinë në deklarin e subjektit, për sa i përket mënyrës së fitimit të pronësisë mbi të gjithë sipërfaqen, pasi vënia në lëvizje e institucioneve përkatëse për kalimin në pronësi dhe regjistrimin e kësaj sipërfaqeje është bërë me kërkesë të babait të subjektit, me qëllim ligjërimit të pronësisë së dy shtëpive, ashtu siç ka pranuar edhe vetë subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision¹⁸, për pasojë, ai ka qenë plotësisht në dijeni të faktit që kalimi i pronësisë së sipërfaqes së tokës është bërë me vendim të Komunës Libonik, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Në analizën e pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se subjekti nuk është konsekuent në deklarin e bërë në deklaratën e rivlerësimit, krahasuar me atë të vitit 2014, në të cilën është shprehur se trualli mbi të cilin është ngritur shtëpia ka qenë në pronësi të tij, pa u shprehur për mënyrën e fitimit të pronësisë.

Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se me të drejtë Komisioni ka vlerësuar që subjekti ka kryer deklarin të rremë, pasi nga analiza e mësipërme rezulton se të dhënat e pasqyruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit plotësojnë kushtet e deklarin të rremë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁷ Ligji nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, në nenin 14 “Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet” parashikon se: “1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.

2. Propozimi për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit në hapësirat e tokës bujqësore bëhet në bazë të studimeve rajonale dhe masterplaneve, vetëm kur është vërtetuar dhe argumentuar:

a) mungesa e plotë e sipërfaqeve të tjera fizike me tokë urbane të lirë, brenda vijave kufizuese të ndërtimit;

b) mungesa e sipërfaqeve me tokë urbane, që mund të ripërdoret nëpërmjet prishjes së ndërtimeve të vjetra dhe kryerjes së ndërtimeve të reja, në përputhje me rregullat dhe normat urbanistike;

c) mungesa e tokave të tjera të pafrytshme ose me vlera më të ulëta pjellorie natyrore, sipas bonitetit.

Argumentimi për këto raste përgatitet nga organi i ngarkuar me ligj për hartimin dhe mbrojtjen e studimit.

3. Strukturat e pushtetit vendor, të ngarkuara për mbrojtjen e tokës bujqësore, në çdo rast, kur nuk janë dakord për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit në hapësirat e tokës bujqësore, i paraqesin ankesë organeve të ngarkuara me ligj.

4. Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.”

¹⁸ Në deklarin e paraqitura në Komision më datë 09.09.2018.

28. Në lidhje me pretendimin e subjektit se burimi i krijimit të kësaj pasurie është plotësisht i ligjshëm dhe se kjo ligjshmëri mund të kontestohet vetëm nga subjekte pretenduese dhe vetëm para një institucioni gjyqësor, sipas nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues çmon se është një pretendim i pabazuar, pasi organet e rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit vlerësojnë fakte dhe prova në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, për të vërtetuar nëse në kuptim të legjislacionit në fuqi, a konsiderohet ose jo si burim i ligjshëm, burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë. Vlerësimi dhe cilësimi që u japin fakteve dhe rrethanave organet e rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit vlejné vetëm për këtë proces, me qëllim identifikimin e subjekteve që nuk plotësojnë kushtet për të qëndruar në detyrë, në përputhje me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.
29. Subjekti, në ankim, pretendon se para se të ndërtonte shtëpinë në fshatin {***}, u është drejtuar organeve kompetente që të pajisej me leje konform të gjitha procedurave ligjore, por për shkak të bllokimit të lejeve zhvillimore nuk është bërë e mundur një gjë e tillë. Subjekti pretendon gjithashtu se për provimin e një fakti të tillë i ka vënë në dispozicion Komisionit një vërtetim të posaçëm, të lëshuar nga këto organe shtetërore. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. {***} prot., datë 11.12.2018, të Njesisë Administrative Libonik, Bashkia Maliq, në të cilin administratori i kësaj njësie vërteton se z. Admir Belishta është paraqitur për të aplikuar për leje zhvillimore ndërtimi, por iu bë me dije se këto leje ishin pezulluar, pavarësisht faktit se në rastin konkret mund të plotësoheshin të gjitha kushtet ligjore.
- Nga përmbajtja e vërtetimit të sipërcituar, trupi gjykues konstaton se akti është lëshuar më datë 11.12.2018 dhe nuk ka asnjë referim në ndonjë akt shkresor të paraqitur nga subjekti pranë këtij institucioni në vitin 2013 ose më parë, që në përputhje me parashikimet e ligjit të kohës nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”, të vërtetonte aplikimin me shkrim të subjektit për leje zhvillimi ose ndërtimi. Ligji i sipërcituar në nenin 73 parashikon që kërkesa për lejen e zhvillimit paraqitet me shkrim pranë komunës ose bashkisë në territorin e së cilës kërkohet zhvillimi, ndërsa në nenin 77, pikat 1 dhe 2 përcakton se “1. Lëshimi i lejes së ndërtimit kryhet vetëm pas shqyrtimit e verifikimit të përputhshmërisë së kërkesës me rregulloret e ndërtimit në fuqi dhe/ose me përcaktimet e lejes të zhvillimit. 2. Çdo leje ndërtimi jepet në bazë të një kërkesë të veçantë, e cila mund të kryhet njëkohësisht me kërkesën për zhvillim, kur lejohet nga rregulloret e kontrollit të zhvillimit”.
- Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se vërtetimi i lëshuar nga Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, nuk vërteton se subjekti ka paraqitur një kërkesë zyrtare pranë këtij institucioni, para se të fillonte ndërtimin e shtëpisë në fshatin {***}. Vërtetimi i sipërcituar hedh dritë mbi faktin se lejet zhvillimore në kohën kur subjekti do të ndërtonte shtëpinë në fshatin {***} ishin të pezulluara, që do të thotë se nuk lejoheshin ndërtimet e strukturave/objekteve në atë periudhë. Por, subjekti, siç pranon edhe vetë në ankim, por edhe gjatë hetimit administrativ, megjithëse u vu në dijeni nga organet shtetërore se në atë periudhë nuk lejoheshin ndërtimet, përsëri ka vendosur të kryejë ndërtimin e shtëpisë dykatëshe, i papajisur me leje zhvillimi ose ndërtimi, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Subjekti, për shkak të formimit të tij profesional, si edhe për shkak të detyrës që kryente si gjyqtar, ka qenë i vetëdijshëm për parashikimet ligjore në fushën e ndërtimit dhe rëndësinë e shkëljes së tyre. Këtë vetëdije të subjektit, trupi gjykues e sheh të lidhur ngushtë edhe me konstatimin se subjekti, ndërtimin e shtëpisë nuk e kishte deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2013, por në atë të vitit 2014, pasi kishte marrë certifikatën e pronësisë mbi sipërfaqen 820 m² dhe kishte kryer procesin e legalizimit nëpërmjet lejes së legalizimit nr. {***}, datë 26.12.2014, proces i cili u bë i mundur vetëm pas

hyrjes në fuqi të ligjit nr. 50/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe pasi e kishte regjistruar këtë pasuri në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Subjekti nuk e ka deklaruar ndërtimin pa leje në vitin 2013, pasi në atë kohë ai ende nuk kishte titullin e pronësisë për parcelën ndërtimore ku kishte bërë ndërtimin pa leje dhe, për më tepër, kjo sipërfaqe toke ishte tokë bujqësore, mbi të cilën nuk lejoheshin ndërtimet. Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së vitit 2013 i shtëpisë së ndërtuar në {***}, në kundërshtim me parashikimet e shkronjës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003¹⁹, ka qenë një përpjekje e subjektit për të mos e deklaruar këtë pasuri, e cila ishte ndërtuar mbi një sipërfaqe së cilës i ishte ndryshuar kategorizimi nga tokë bujqësore në tokë truall, në kundërshtim me legjislacionin administrativ dhe penal në fuqi, si dhe ishte ndërtuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për lejimin e ndërtimeve dhe që, për më tepër, kryerja e një ndërtimi të paligjshëm ka qenë parashikuar nga ligji si veprë penale, që nga viti 2008.

Edhe pretendimi i subjektit në ankim, se arsyeja që deklarimin e ka bërë në vitin 2014 është fakti se ndërtimi i shtëpisë si i tillë ka përfunduar në fund të vitit 2013, por pagesat janë kryer në vitin 2014, përsëri nuk e shëron pasaktësinë e tij në deklarimin e vitit 2013. Subjekti, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka deklaruar se për ndërtimin e shtëpisë në vitin 2013 ka shpenzuar vlerën 661.692 lekë për punime ndërtimi të kryera nga punëtorë të ndryshëm e për pasojë të pambuluara me fatura. Për diferencën e shpenzimeve ndërmjet vlerës totale të ndërtimit të pretenduar, prej 2.100.000 lekësh, dhe vlerës prej 661.692 lekësh, subjekti ka paraqitur fatura tatimore shitjeje me përshkrim për blerjen e materialeve drusore. Këto fatura u përkasin viteve 2013 dhe 2014, përkatësisht në vlerat 915.384 lekë dhe 522.924 lekë. Bazuar në këto pretendime të subjektit, për të qenë në kushtet e një deklarimi të saktë, ai, në vitin 2013 do të duhej të kishte deklaruar vlerën e punimeve të ndërtimit prej 661.692 lekë, ndërsa vlerën 915.384 lekë, të rrjedhur nga faturat tatimore të vitit 2013, duhet ta kishte deklaruar si detyrime ndaj të tretëve.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka kryer deklarimin e shpenzimeve të kryera për këtë ndërtim në vitin 2013, kur ndërtimi ka përfunduar, si dhe detyrimet ndaj të tretëve për këtë vit, por i ka deklaruar në vitin 2014, kur ka kryer edhe procedurat për legalizimin e këtij ndërtimi, duke plotësuar kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

30. Në vlerësimin e trupit gjykues, tërësia e veprimeve për kryerjen e ndërtimit të shtëpisë në {***} pa lejet përkatëse, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për zhvillimin e territorit, si dhe për përfitimin e një pasurie truall në kundërshtim me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 05.09.2012 dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e tokës bujqësore²⁰, tregojnë një raport të tillë të subjektit me zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Rëndësia e sjelljes jashtëgjiqësore të gjyqtarit, dhe ndikimi i saj në besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare për sjelljen e gjyqtarëve, si:

¹⁹ Në nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, parashikohet se: “4. Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]”.

²⁰ Shih paragrafët 26-28 të këtij vendimi.

Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë²¹, Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësor²² e të tjera akte ndërkombëtare, si dhe e jurisprudencës së GjEDNj-së²³, të cilat theksojnë se shkelja e ligjit nga një gjyqtar jo vetëm dëmton reputacionin e funksionit si gjyqtar, por inkurajon mosrespektimin e ligjit dhe cenon besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit. Këto rrethana marrin rëndësi edhe për faktin se subjekti ka qenë kryetar i gjykatës për një periudhë të gjatë kohe, duke e ekspozuar atë posaçërisht në cenimin e besimit të publikut, në kushtet kur ai duhet të kujdesej që edhe sjellja e gjyqtarëve të tjerë të gjykatës që drejtonte, të ishte e denjë në sytë e publikut.

Në vlerësimin e trupit gjykues, këto rrethana të cituara më lart, janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, që përbën një shkak të veçuar shkarkimi nga detyra të subjektit, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

31. Subjekti, në ankim, pretendon se refuzimi i Komisionit për kryerjen e këqyrjes në vend, si dhe të një ekspertimi vlerësues për të përcaktuar cilësinë e materialeve të ndërtimit, si dhe koston e saktë të ndërtimit të shtëpisë në fshatin {***}, i kanë cenuar atij një të drejtë kushtetuese, të sanksionuar edhe në aktet ndërkombëtare, në funksion të një procesi të rregullt. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur kërkesën me lëndë “Marrje provash”, në pikën 9 të së cilës ka kërkuar “Këqyrjen në vend për shtëpinë e ndërtuar në fshatin {***} ose ekspertim vlerësues”. Komisioni, me vendimin nr. 04, datë 17.12.2018, ka vendosur të refuzojë këtë kërkesë të subjektit, duke arsyetuar se, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “d” dhe pika 7 e ligjit nr. 84/2016, pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. Në vijim, Komisioni është shprehur se shpjegimet e subjektit në lidhje me shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e kësaj shtëpie do të shqyrtohen gjatë procesit të vendimmarrjes.

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, bazuar në situatën faktike si më sipër, trupi gjykues çmon se në rezultatet e hetimit administrativ, si dhe në vendim, Komisioni, në analizën financiare të kryer për vitin 2013, ka përllogaritur vlerën e shtëpisë së ndërtuar nga subjekti në fshatin {***}, në vlerën e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pa abstraguuar mbi cilësinë e materialeve të ndërtimit e për rrjedhojë për një kosto më të lartë të ndërtimit të saj. Në këto kushte, vendimi i Komisionit për refuzimin e kërkesës së subjektit për kryerjen e këqyrjes në vend ose ekspertimit vlerësues për shtëpinë e ndërtuar në fshatin {***}, është i drejtë.

32. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, për shtëpinë e ndërtuar në fshatin {***}, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit

²¹ Kodi i Etikës Gjyqësore²¹, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare më datë 08.12.2006, në rregullën 3 parashikon: “Gjyqtari nuk duhet të lejojë që familja, të afërmit e tij apo persona të tjerë të influencojnë në punën dhe vendimet e tij. Ai nuk duhet të cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave privatë dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t’u krijojë të tjerëve përshtypjen se vepron në mënyrë të tillë”.

²² Komentari i Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, në paragrafin 108, shpjegon: “[...] Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe të dëmtojë imazhin e gjyqtarit e të ngrejë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit në tërësi.”

²³ GjEDNj, në çështjen Baka k. Hungarisë (Dhoma e Madhe, 2016), është shprehur: “Gjykata në shumë raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit, i cili, si një garantues i drejtësisë, njëri nga vlerat themelore të shtetit të së drejtës, duhet të gëzojë besimin e publikut që të jetë i suksesshëm në kryerjen e detyrës së tij”.

nr. 84/2016; ka kryer deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me mënyrën e përfitimit të truallit prej 470 m², në të cilin ka ndërtuar këtë shtëpi, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016; nuk ka kryer deklarimin e shpenzimeve të kryera për këtë ndërtim në vitin 2013, kur ndërtimi ka përfunduar, si dhe detyrimet ndaj të tretëve, por i ka deklaruar në vitin 2014, kur ka kryer edhe procedurat për legalizimin e këtij ndërtimi, duke qenë në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë në deklaratën e pasurisë së vitit 2013, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

33. *Lidhur me pretendimin e subjektit se për pasurinë automjet Mercedes Benz, vit prodhimi 2002, në pronësi të tij, konstatimet dhe konkluzionet e Komisionit janë të paargumentuara dhe kontradiktore, pasi Komisioni, nga njëra anë nuk ka vlerësuar faktet e deklaruara nga vetë shitësi në deklaratën noteriale, ndërsa nga ana tjetër ka refuzuar kërkesën e subjektit për ta marrë në cilësinë e dëshmitarit, duke e cenuar në të drejtën për të paraqitur prova dhe se Komisioni nuk ka argumentuar në vendim pse nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet juridiko-ekonomike të subjektit në lidhje me mundësinë e tij financiare për blerjen e automjetit, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit dhe nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues në lidhje me të, duke qenë në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.*
34. *Trupi gjykues konstaton se nga hetimi i Komisionit²⁴ ka rezultuar se subjekti, me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2013, ka blerë automjetin Mercedes Benz, tip 220, nga shitësi P. A., në vlerën 600.000 lekë. Z. P. A. e ka blerë më parë këtë mjet nga shitësja E. B., nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.02.2010, me vlerë 15000 euro, në të cilën automjeti figuron i përshkruar si Mercedes Benz i tipit 320 CDI. Pasi ka administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe argumentet e dhëna prej tij në seancë dëgjimore publike, në vendim, në përfundimet e arritura për këtë pasuri, Komisioni ka arsyetuar se subjekti nuk arriti të bindë trupin gjykues për vërtetësinë e çmimit të blerjes së këtij mjeti, ndërsa në konkluzionet përfundimtare në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë²⁵, Komisioni nuk ka renditur asnjë përfundim në lidhje me sa më sipër. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, rezulton se Komisioni nuk e ka ngarkuar atë me përgjegjësi, në lidhje me vërtetësinë e çmimit të blerjes së automjetit Mercedes Benz, në vitin 2013. Por pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e subjektit në ankim, se çmimi i paguar prej tij, i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së automjetit në vitin 2013, është çmimi real dhe i vërtetë i blerjes, bazuar në gjendjen teknike të mjetit. Ai ka pretenduar gjithashtu se ndryshimi i tipit të automjetit nga tip 320 CDI në tip 220 mbi të cilin Komisioni ka mbështetur arsyetimin për një çmim joreal shitjeje, është thjesht një lapsus i noteres që ka përpiluar kontratën e shitblerjes. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues verifikoi të dhënat e lejes së qarkullimit rrugor në dosjen e automjetit e përcjellë në Komision nga DPTRr, në të cilën, në rubrikën e karakteristikave të mjetit, automjeti Mercedes Benz është përshkruar: *lloji autoveturë, marka Mercedes Benz, tipi 220, modeli S320 CDI*. Këto të dhëna janë përshkruar edhe nga noterja në*

²⁴ DPTRrSh-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2018, ka depozituar në Komision dosjen e plotë të automjetit Mercedes Benz, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

²⁵ Shih faqen 29 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.

kontratën e shitblerjes së datës 17.04.2013. Trupi gjykues vëren se në kontratat e mëparshme të shitblerjes së këtij mjeti, noterët kanë përshkruar të dhënat e modelit si të dhëna për tipin e autoveturës. Në përfundim të këtij verifikimi, trupi gjykues vlerëson se në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2013, me palë blerëse subjektin e rivlerësimit dhe palë shitëse z. P. A., në kundërshtim me sa konstaton Komisioni, noterja ka përshkruar saktë të dhënat e automjetit Mercedes Benz, objekt i kontratës së shitblerjes.

35. Në ankim, subjekti pretendon se i është cenuar e drejta për të paraqitur prova, pasi Komisioni nga njëra anë nuk ka vlerësuar faktet e deklaruara nga vetë shitësi në deklaratën noteriale, ndërsa nga ana tjetër ka refuzuar kërkesën e subjektit për ta marrë shitësin në cilësinë e dëshmitarit. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të dërguara në Komision, në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale, datë 11.12.2018, të z. P. A., si dhe kërkesën me lëndë “Marrje provash”, në pikën 25 të së cilës ka kërkuar edhe thirrjen si dëshmitar të z. P. A. Komisioni, me vendimin nr. 04, datë 17.12.2018, bazuar në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur të refuzojë këtë kërkesë të subjektit, duke arsyetuar se z. P. A. ka dhënë dëshminë e tij me shkrim, duke e bërë të panevojshme thirrjen e tij si dëshmitar. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, bazuar në situatën faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se në procesin e rivlerësimit, bazuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës i përket subjektit të rivlerësimit. Në rastin konkret, subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur deklaratën noteriale të z. P. A., në të cilën ai sqaron arsyet e shitjes së automjetit në çmimin e përcaktuar në kontratën e shitblerjes të lidhur mes tij dhe subjektit të rivlerësimit, në vitin 2013. Për këtë arsye, duke qenë se z. P. A. e ka dhënë dëshminë e tij me shkrim, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit për refuzimin e kërkesës së subjektit për pyetjen e z. P. A. ka qenë i drejtë, bazuar në nenin 49, pika 6, fjalia e parë dhe shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme”.
36. Subjekti, në ankim, kundërshton vendimmarrjen e Komisionit në lidhje me vlerësimin e mundësive të tij financiare për blerjen e automjetit Mercedes Benz, në vitin 2013. Ai pretendon, gjithashtu, se Komisioni nuk ka argumentuar shkaqet apo arsyet pse nuk ka marrë në konsideratë të gjitha argumentet juridiko-ekonomike të paraqitura prej tij. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim²⁶, ka vlerësuar se *provat dhe shpjegimet e subjektit kanë përmirësuar situatën e tij financiare në përballimin e blerjes së kësaj pasurie, por përsëri rezultati del negativ*, në vlerën 489130 lekë. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka marrë parasysh shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti dhe madje këtë e ka reflektuar edhe në rezultatin e analizës financiare. Në përgjigje të pretendimit të subjektit se ka pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e automjetit, trupi gjykues, për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit për të blerë automjetin Mercedes Benz në çmimin 600.000 lekë, kreu analizën financiare duke e shtrirë atë nga data 1 janar 2013 deri në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes të datës 17.04.2013, nga e cila rezulton se ai ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në vlerën 295.264 lekë. Shtrirja e kësaj analize nga trupi gjykues deri në fund të vitit 2013, në përjasje të analizës që ka zhvilluar

²⁶ *Shih faqen 26 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.*

Komisioni, prodhon një rezultat prej 449.512 lekë mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni, se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit Mercedes Benz, është i drejtë.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet Mercedes Benz në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij mjeti, siç parashikohet në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

37. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mosdeklarimi fillestar i pasurisë së bashkëshortes në familjen e saj para martesë ka qenë thjesht një pakujdesi, e pashoqëruar me ndonjë motiv tjetër. Konkluzioni i Komisionit se bashkëshortja e subjektit duhet të kishte deklaruar këtë pronë, nuk është i drejtë, pasi ai i ka provuar Komisionit me dokumentacion ligjor se as bashkëshortja e as familjarët e saj nuk e kanë përdorur këtë pronë dhe nuk kanë nxjerrë të ardhura prej saj. Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi, konstaton se në vendim, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarim të pasurive të bashkëshortes, që nga momenti i lidhjes së tyre në martesë, për pasojë ai nuk ka qenë i saktë në deklarimin e pasurisë së tij ndër vite. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit, znj. E. B., ka plotësuar vetëm rubrikën “Autorizim për kontrollin e deklaratës së interesave”, duke deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas, të regjistruar në emër të saj dhe në deklarimet e pasurisë ndër vite nuk ka deklaruar asnjëherë pronësi, si pjesë takuese në tokë bujqësore, truall apo banesë. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i është drejtuar noterit B. Z., me kërkesën për t’i vënë në dispozicion aktet noteriale të kryera pranë këtij noteri nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Noteri B. Z., me shkresën nr. {***} prot., datë 14.04.2018, ka dërguar në Komision aktet e kërkuara noteriale, ndërmjet të cilave edhe një deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, me deklaruese bashkëshorten e subjektit, znj. E. B., e cila deklaroi: *Jam trajtuar me tokë bujqësore, truall dhe banesë me ligjin nr. 7501 për prona të ndodhura në fshatin {***}, Devoll, sipas AMTP nr. {***}, datë 08.12.2005, me kryetar të familjes bujqësore babain tim, V. K. Meqenëse unë jam larguar nga familja bujqësore, sepse jam martuar, për pjesën time që kam në tokën bujqësore, truall dhe ndërtesë, nuk kam kërkuar të marr nga familja bujqësore e babait tim. Deklaroj se heq dorë nga çdo e drejtë që kam përfituar në këto pasuri dhe nuk kam asnjë pretendim në lidhje me këto prona, që jam bashkëpronare, unë deklaroj se jam kryetar familje bujqësore, babain tim.**

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. {***} prot., datë 13.03.2018, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. E. K. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në zyrën e gjendjes civile në Bruklin, më datë 10.12.2012, dhe veprimet për zbatimin e aktit të martesës në Shqipëri janë bërë më datë 07.11.2013, në zyrën e gjendjes civile të Bashkisë Korçë.

38. Gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision²⁷ dhe në ankim, subjekti ka deklaruar se është plotësisht i vërtetë fakti që bashkëshortja e tij ka përfituar tokë bujqësore dhe se ka qenë bashkëpjesëtare në shtëpinë e prindërve dhe truallin funksional të kësaj shtëpie, por kjo nuk është deklaruar në momentin fillestar të lidhjes së martesës, si rezultat i një neglizhence apo harrese,

²⁷ Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

nisur edhe nga fakti se nga kjo pasuri nuk është përfituar asnjë lloj e ardhure. Për të provuar këtë deklaram, bashkëlidhur shpjegimeve subjekti ka paraqitur si provë vërtetimin nr. {***} prot., datë 11.12.2018, të Njesisë Administrative {***}, Bashkia Devoll, sipas të cilit znj. E. V. K. është trajtuar me tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar dhe nuk ka realizuar të ardhura nga toka.

39. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, bazuar edhe në dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, të përshkruar si më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë vlerësimi i Komisionit për sa i përket pasaktësisë së personit të lidhur të subjektit në deklaramin e pasurisë ndër vite. Bazuar në nenin 4, shkronja “a”, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, bashkëshortja e subjektit kishte detyrimin për deklaramin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, që nga viti 2013, kur është zbatuar në Shqipëri akti i martesës me subjektin e rivlerësimit. Edhe në kushtet e mospërdorimit të kësaj prone, apo mosnxjerrjes së të ardhurave prej saj, siç pretendon subjekti, përsëri bashkëshortja kishte detyrimin ta deklaronte pjesën takuese në deklaramin periodik të vitit 2013. Veprimi i heqjes dorë nga pronësia, nga bashkëshortja e subjektit vetëm 5 ditë para dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit, ushqen argumentin se bashkëshortja e subjektit ka qenë në vetëdije të mosdeklaramit të kësaj pasurie në deklaratat periodike të pasurisë, duke plotësuar kështu kushtet për ta konsideruar mosdeklaramin e saj si pasaktësi, në kundërshtim me parashikimet të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
40. Në vazhdim të arsytimit në lidhje me pasuritë e padeklaruara të bashkëshortes së subjektit, trupi gjykues konstaton se znj. E. B., nëpërmjet aktit noterial, më datë 25.01.2017, ka hequr dorë nga pjesa e saj takuese tokë bujqësore në bashkëpronësinë në tërësi të familjes bujqësore, për rrjedhojë, pavarësisht se nuk është shprehur në mënyrë eksplicite në deklaratën noteriale, pjesa e saj takuese shkon në dobi të anëtarëve të tjerë të familjes bujqësore, me kryefamiljar babain e saj. E njëjta situatë është edhe për pasuritë truall dhe ndërtesë, në të cilat ajo është bashkëpronare. Kodi Civil, në nenin 191, paragrafi i dytë parashikon se: “Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet.” Kjo dispozitë parashikon një formë të veçantë të kalimit të pronësisë dhe e kushtëzon këtë formë me aktin noterial dhe regjistrimin për efekt vlefshmërie.²⁸ Në kuptim të këtij parashikimi, subjekti i rivlerësimit, as bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe as në seancën dëgjimore në Komision nuk ka provuar regjistrimin e heqjes dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme nga bashkëshortja e tij. Për këtë arsye, për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se znj. E. B. gëzon ende të drejta reale mbi pasuritë e paluajtshme tokë bujqësore, truall dhe ndërtesë në fshatin {***}, Devoll, për rrjedhojë Komisioni duhet ta kishte konstatuar dhe analizuar këtë fakt, duke vlerësuar se ajo duhet t’i kishte deklaruar këto pasuri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
41. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarami i pjesës takuese të pasurisë së paluajtshme të bashkëshortes as në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as në deklaratat e pasurisë në vite, e vendos subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

²⁸ Shihni vendimin nr. {***}, datë 20.02.2018, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

42. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2011-2014 është e paargumentuar dhe e pabazuar në prova, duke konkluduar në mënyrë të pasaktë për pamjaftueshmëri të burimeve financiare për të përballuar shpenzimet e kryera nga subjekti për këto vite. Komisioni nuk ka argumentuar në vendim arsyet pse nuk i ka marrë parasysh shpjegimet e subjektit, duke cenuar kështu rregullat e parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me arsyetimin e plotë dhe të detajuar të vendimit.*
Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, duke i krahasuar ato me të dhënat e analizës financiare të kryer nga Komisioni, për secilin vit të periudhës 2011-2014, si më poshtë.
43. Subjekti pretendon se vlera e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, në analizën financiare për secilin vit, nuk është përlogaritur drejt nga Komisioni. Trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit lidhen me mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të deklarimeve të subjektit se në udhëtimet jashtë vendit ai ka qëndruar te të afërmit e tij, duke mos pasur shpenzime akomodimi, por vetëm shpenzime për pagesën e biletave të udhëtimeve. Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka paraqitur akte provuese të mjaftueshme për të provuar se:
- në vitin 2011, ka qëndruar te z. J. Ç.²⁹ gjatë udhëtimit në Nju Jork dhe te z. A. D. gjatë një udhëtimi në Bruksel;
 - në vitin 2012, për udhëtimet private drejt Greqisë, ka qëndruar te miq e të afërm;
 - në vitin 2013, për një udhëtim të kryer në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shpenzimet e akomodimit janë përballuar nga një i afërm i tij, z. F. K.;
 - në vitin 2014, për një udhëtim në Gjermani, shpenzimet për ushqim dhe akomodim janë përballuar nga miku i tij, z. M. G.
- Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konsiderimi i Komisionit se këto udhëtime janë kryer me shpenzimet e vetë subjektit.
44. Në lidhje me pretendimin e subjektit se disa udhëtime të kryera në Francë, Uashington, Serbi, Turqi, Korfuz, kanë qenë udhëtime pune, për të cilat ai nuk ka kryer shpenzime, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të vërtetuar se këto udhëtime janë përballuar me shpenzime të buxhetit të shtetit ose janë mbuluar me financim nga organizatorët e aktiviteteve përkatëse, në kuptim të parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.02.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit” dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 4.02.2011, të Këshillit të Ministrave”.
45. Trupi gjykues, pasi analizoi situatën faktike si më sipër, në zbatim të metodologjisë së miratuar në jurisprudencën e tij³⁰, arriti në konkluzionin se shpenzimet e përlogaritura nga Komisioni në zërin shpenzime udhëtimi për secilin vit të analizës financiare janë të drejta, për rrjedhojë këto do të jenë vlerat që do të konsiderohen në vijim të arsyetimit për vlerësimin e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit.
46. Subjekti pretendon se Komisioni pa të drejtë ka refuzuar kërkesën e tij për të thirrur si dëshmitarë shtetasit që e kanë mikpritur atë në udhëtimet private jashtë shtetit, si dhe kërkesën

²⁹ *Subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur një dokument nga shteti i Nju Jorkut për kthimin e tatimit mbi të ardhurat individuale për z. J. Ç.*

³⁰ *Shih vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

për të kryer një ekspertim kontabël me ekspertë të fushës për të përlogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e tij. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni me vendimin nr. 04, datë 17.12.2018³¹, ka vendosur të refuzojë këtë kërkesë të subjektit të paraqitur bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke arsyetuar se bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, shpjegimet e subjektit do të shqyrtohen gjatë procesit të vendimmarrjes. Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kërkuar që të thirren si dëshmitarë në proces, persona të cilët jetojnë jashtë shtetit. Kjo ka qenë një zgjedhje e subjektit për të kërkuar provën, por këtë provë e ka kërkuar të merret nga Komisioni, ndërkohë që barra e provës i përket atij³² dhe ai duhet të kishte gjetur mënyrën e duhur për të bërë të mundur marrjen e deklarimeve/dëshmimeve të këtyre personave. I njëjti arsyetim vlen edhe për kryerjen e ekspertimit kontabël. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit për refuzimin e kërkesës së subjektit për kryerjen e ekspertimit kontabël dhe thirrjen e personave që e kanë mikpritur në udhëtimet e tij jashtë vendit, është i drejtë.

47. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka argumentuar në vendim arsyet pse nuk i ka marrë parasysh shpjegimet e tij në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, duke cenuar kështu rregullat e parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me arsyetimin e plotë dhe të detajuar të vendimit. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ, në analizën financiare, në zërin e shpenzimeve të udhëtimit, për secilin vit, Komisioni ka përlogaritur këto vlera: për vitin 2007 – 244.990 lekë; për vitin 2008 – 218.033 lekë; për vitin 2011 – 591.233 lekë; për vitin 2012 – 568.660 lekë; për vitin 2013 – 658.286 lekë; për vitin 2014 – 390.907 lekë. Në vendim³³, Komisioni ka arsyetuar se pasi ka marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimeve të vërtetuara nga subjekti, sipas dokumentacionit shoqëruar, në zërin e shpenzimeve të udhëtimit në analizën financiare, vlerat kanë ndryshuar: për vitin 2007 – 126.498 lekë; për vitin 2008 – 35.723 lekë; për vitin 2011 – 523.455 lekë; për vitin 2012 – 366.066 lekë; për vitin 2013 – 604.305 lekë; për vitin 2014 – 340.000 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se Komisioni i ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe i ka vlerësuar ato, duke përlogaritur vlera më të ulëta të shpenzimeve të kryera nga subjekti për udhëtimet jashtë vendit.

Megjithëse subjekti nuk ka qenë specifik në pretendimin e tij se cilat nga rregullat e parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me arsyetimin e plotë të vendimit janë cenuar nga Komisioni, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson të mbështetet në jurisprudencën e GjEDNj, e cila në çështjen Van de Hurk k. Holandës, 1994³⁴, ka mbajtur qëndrimin se “Aplikanti paraqiti një sërë ankesash, të cilat mund të përmblihen në pretendimin se në gjykimin e tij, Gjykata e Apelit Industrial nuk iu përgjigj fare ose nuk iu përgjigj mjaftueshëm të gjitha argumenteve të paraqitura prej aplikantit. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e marra prej tyre, por kjo nuk mund të kuptohet se kërkohet një përgjigje

³¹ Ky vendim i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 19.12.2018, nëpërmjet shërbimit postar dhe subjekti i rivlerësimit e ka marrë njoftimin më datë 27.12.2018, në kartelën postare është shënuar Admir Belishta, Gjykata e Rrethit Korçë, pa nënshkrim. Në ankim, subjekti ka pranuar se është njohur me këtë vendim të Komisionit.

³² Sipas parashikimeve të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës në procesin e rivlerësimit i kalon subjektit të rivlerësimit.

³³ Shih faqen 29 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.

³⁴ Paragrafi 61 i vendimit të GJEDNj-së në çështjen Van de Hurk k. Holandës, 1994 .

e detajuar për secilin argument. Në përgjithësi, gjykata nuk e gjen vendimin e Gjykatës së Apelit Industrial si të paarsyetuar. Për pasojë nuk ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së.³⁵”

Në zbatim të kësaj jurisprudence në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit, se vendimi i Komisionit nuk është arsyetuar në mënyrë të plotë, nuk qëndron.

48. Subjekti, ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit edhe për vlerën 180.000 lekë, e vendosur në zërin shpenzime mobilimi, si vlerë joreale, por e hamendësuar nga Komisioni, duke e shtrirë këtë argument kundërshtues për të gjitha vitet e analizës financiare. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se kjo vlerë e përlllogaritur nga Komisioni është vlere e deklaruar nga vetë subjekti në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, për rrjedhojë vlerëson se ajo është përlllogaritur drejt nga Komisioni.
49. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me zërat e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, mobilimit dhe të jetesës në analizën financiare të prodhuar nga Komisioni për vitet 2011 dhe 2012 nuk janë të bazuara në dokumentacionin e paraqitur prej tij gjatë hetimit administrativ, për rrjedhojë konkluzioni i Komisionit se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve në këto vite, është i drejtë.
50. Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se nuk janë përlllogaritur saktë shpenzimet e jetesës për vitet 2013 dhe 2014, me argumentin se megjithëse familja e tij në këto vite ka qenë e përbërë nga tre persona, shpenzimet e kryera për fëmijën e tij kanë qenë simbolike dhe, si të tilla, nuk duhet të ishin konsideruar nga Komisioni. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se standardi i përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në INSTAT, për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës gjatë ushtrimit të kontrollit nga ky institucion, bazohet jo në moshën e anëtarëve të familjes, por në numrin e tyre dhe në këtë kontekst nuk e gjen të drejtë pretendimin e subjektit. Trupi gjykues konstaton se në analizën financiare për vitet 2013 dhe vitin 2014, Komisioni ka përlllogaritur vlerën 521.793 lekë si shpenzime jetese për familjen e subjektit të përbërë nga tre anëtarë, vlerë kjo që nuk përputhet me të dhënat e publikuara nga INSTAT për konsum ushqimor për frymë dhe familjar, të përdorura nga ILDKPKI-ja. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në rastin konkret, duhet të kishte përlllogaritur shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në INSTAT³⁶, në vlerën 423.072 lekë për vitin 2013, ndërsa për vitin 2014 kjo vlerë duhet të ishte 659.994 lekë. Në një qëndrim sa më garantist kundrejt subjektit të rivlerësimit, duke qenë se prej tij është pretenduar një shpenzim mujor jetese më i ulët, trupi gjykues vlerëson të konsiderojë vlerën e përlllogaritur nga Komisioni për shpenzimet e jetesës në vitin 2014, meqenëse ajo është më e vogël sesa vlere e përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT.

Trupi gjykues vëren se Komisioni, në konkluzionin për mungesën e burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2013, ka përfshirë edhe mungesën e burimeve për blerjen e automjetit Mercedes Benz sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2013. Trupi gjykues çmon se për një vlerësim më të drejtë dhe të mbështetur në dokumentacionin e administruar, Komisioni duhet të kishte

³⁵ Të njëjtin qëndrim, kjo gjykatë e ka mbajtur edhe në vijim, në çështjet Garcia Ruiz k. Spanjës, 1999; Perez k. Francës, 2004 etj.

³⁶ Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas shkresës së ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 04.03.2019, dhe protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

kryer analizën financiare për blerjen e automjetit deri në datën 17.04.2013, datë në të cilën është lidhur kontrata noteriale e shitblerjes, në të cilën palët kanë deklaruar se çmimi prej 600.000 lekësh është likuiduar tërësisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Trupi gjykues kreu analizën financiare sipas situatës faktike të blerjes së pasurisë, nga ku rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit Mercedes Benz, në vlerën 266.193 lekë. Në këtë analizë financiare nuk u përfshinë kursimet *cash* të akumuluarat të subjektit, deri në fund të vitit 2012, pasi bazuar në deklaratimet e tij në deklaratat periodike të viteve 2013 dhe 2014, këto kursime nuk janë përdorur për blerjen e automjetit. Trupi gjykues, në përjashtë me analizën e kryer nga Komisioni, kreu analizën financiare për gjithë vitin 2013, nga e cila rezulton se burimet e ligjshme financiare të subjektit për të përballuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive të deklaruara në këtë vit, paraqiten përsëri me një gjendje financiare negative, por në vlerën prej 394.382 lekësh. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit për analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2013, nuk janë të bazuara, për rrjedhojë konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive në vitin 2013, është i drejtë.

51. Subjekti, në ankim ka kundërshtuar dhe vlerën e shpenzimeve të ndërtimit për shtëpinë në fshatin {***}, si dhe vlerën e shpenzimeve të mobilimit të kësaj shtëpie, ashtu si janë përlllogaritur në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2014. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, në analizën financiare për vitin 2014³⁷, ka pasqyruar vlerën 2.600.000 lekë si shpenzime për ndërtimin e shtëpisë në fshatin {***}, dhe vlerën 280.000 lekë në zërin shpenzime mobilimi. Subjekti, në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar si shumë të shpenzuar për ndërtimin dhe mobilimin e shtëpisë në fshatin {***}, vlerën totale 2.600.000 lekë. Në deklaratën periodike të pasurisë, në vitin 2014, ka deklaruar *pakësime si rezultat i ndërtimit të shtëpisë në fshatin {***} në vlerën 2.200.000 lekë*. Për sa u përket shpenzimeve të mobilimit të kësaj shtëpie, në deklaratimet gjatë hetimit administrativ në Komision³⁸, subjekti ka shpjeguar se nga vlera totale prej 2.600.000 lekësh e shpenzimeve për shtëpinë në fshatin {***}, ka shpenzuar për mobilim vlerën 500.000 lekë, ndërsa në ankim shpjegon se në vlerën 2.200.000 lekë të deklaruar në vitin 2014, janë përfshirë 2.100.000 lekë si shpenzime ndërtimi dhe 100.000 lekë si shpenzime mobilimi. Pjesa tjetër e vlerës së mbetur për mobilim, prej 400.000 lekësh, është kryer si shpenzim në mënyrë progresive në vitet e mëpasshme.

Në analizë të pretendimit të subjektit në raport me deklaratimet e tij në deklaratat e pasurisë dhe gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se vlera prej 280.000 lekësh, e vendosur nga Komisioni në zërin shpenzime mobilimi, është e drejtë, pasi në të janë përfshirë dy vlera të deklaruara nga vetë subjekti³⁹, vlera 180.000 lekë për mobilimin e apartamentit me sipërfaqe 107 m² dhe vlera 100.000 lekë për mobilimin e shtëpisë në fshatin {***}, ndërsa vlera prej 2.600.000 lekësh, e vendosur nga Komisioni në zërin shpenzime për ndërtim shtëpie në {***}, nuk është e drejtë, pasi ky shpenzim duhet të ishte në vlerën 2.100.000 lekë.

Trupi gjykues kreu analizën financiare për vitin 2014, bazuar në arsyetimin e mësipërm, nga e cila rezulton se megjithëse u morën në konsideratë pretendimet e subjektit për disa nga zërat e analizës financiare të kryer në Komision, të cilat u vlerësuan si të drejta, burimet e ligjshme

³⁷ Shih faqen 29 të vendimit të Komisionit nr. 93, datë 21.12.2018.

³⁸ Në deklaratimet e dërguara në Komision më datë 09.02.2018.

³⁹ Subjekti i ka deklaruar këto vlera në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

financiare të subjektit për të përballuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive të deklaruar në vit, paraqiten përsëri me një gjendje financiare negative, në vlerën 317.344 lekë.

52. Trupi gjykues, në lidhje me analizën financiare të vitit 2014, shqyrtoi pretendimet e subjektit në raport me secilin prej zërave të kësaj analize, bazuar në arsyetimin e bërë nga Komisioni, sipas të cilit shpenzimet e ndërtimit dhe të mobilimit të shtëpisë në {***} janë kryer nga subjekti në këtë vit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues vlerëson se mbështetur në dokumentacionin e administruar nga Komisioni, i shqyrtuar në harmoni edhe me deklaratimet e vetë subjektit gjatë hetimit administrativ dhe në ankim, gjatë gjykimit rezultoi e provuar se subjekti ndërtimin e shtëpisë në {***} e ka përfunduar në gusht të vitit 2013⁴⁰. Për këtë arsye, Komisioni, shpenzimet e ndërtimit të shtëpisë në {***}, të paktën në vlerën 661.692 lekë, nuk duhet t'i kishte përlogaritur në analizën financiare të vitit 2014, por në atë të vitit 2013, bazuar në deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ. Nëse analiza financiare për vitin 2013 do të kryhej sipas këtij arsyetimi, atëherë subjekti do të rezultonte me një mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 1.156.074 lekë. Nëse analiza financiare do të kryhej e fragmentarizuar deri në fund të muajit gusht të këtij viti, datë në cilën shtëpia ka rezultuar e përfunduar së ndërtuari, mungesa e burimeve të ligjshme për vitin 2013 do të rezultonte në vlerën 1.629.251 lekë.
53. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se për secilin vit të periudhës 2011-2014, subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive në këtë periudhë, duke qenë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.
54. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur këto akte, të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës:
- a) vërtetim i Bashkisë Maliq, nr. {***} prot., datë 22.01.2019, sipas të cilit z. A. B. punon me detyrë teknik pyjesh, me pagë mujore neto 33.083 lekë;
 - b) vërtetim i Bashkisë Maliq, nr. {***} prot., datë 22.01.2019, sipas të cilit z. A. B. merr shpërbllim si kryeplak i fshatit {***} një pagë mujore neto prej 6.375 lekësh;
 - c) vërtetim i ISSh-së, Drejtoria Rajonale Korçë, nr. {***} prot., datë 25.01.2019, sipas të cilit znj. M. B. merr pension pleqërie në masën 15.148 lekë;
 - d) vërtetim i AKU-së, Korçë, nr. {***} prot., datë 23.01.2019, sipas të cilit z. B. B. merr pagë mujore neto 54.200 lekë;
 - e) vërtetim i DAR-it, Korçë, datë 22.01.2019, sipas të cilit znj. E. B. merr pagë mujore neto 43.506 lekë.

Këto akte, subjekti pretendon se po i paraqet për të provuar se dekorimet e tjera, si kangjellat rrethuese etj., të shtëpisë në pronësi të tij në fshatin {***} janë ndërtuar nga familjarët e tij, të cilët kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të kryer këto dekorime. Bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, aktet e sipërcituara nuk u morën si provë nga trupi gjykues i Kolegjtit, sepse subjekti nuk ka provuar në ankim pamundësinë e paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, kur edhe ka shprehur të njëjtat pretendime si në ankim. Por, edhe nëse këto akte do të ishin në plotësim të kriterëve të parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar, marrja e tyre si provë do të ishte e panevojshme, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, sepse sipas fotografimit satelitor të shtëpisë në fjalë, të bërë

⁴⁰ Shih paragrafin 29 të këtij vendimi.

më datë 20.08.2013 dhe të përcjellë në Komision nga ALUIZNI, rezulton se kangjellat, muri rrethues etj., kanë qenë të ndërtuar që në vitin 2013, ndërsa vërtetimet e paraqitura nga subjekti përmbajnë të dhëna mbi pagat e familjarëve, të cilat i përkasin vitit 2018.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës

55. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNj-së, pasi i është shkelur e drejta e aksesit te të gjitha aktet e provat e mbledhura për të, si dhe për t'u ballafaquar me to, për pasojë i është mohuar edhe e drejta e realizimit të një mbrojtjeje objektive dhe efektive, trupi gjykues nga verifikimi i akteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, konstaton se Komisioni, më datë 04.12.2018, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ dhe për kalimin e barrës së provës mbi këto rezultate, për të drejtën e njohjes me provat e administruara gjatë hetimit, mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, afatin brenda të cilit mund të ushtrojë këto të drejta, si dhe afatin për të paraqitur prova dhe shpjegime me shkrim⁴¹. Më datë 07.12.2018, subjekti ka ushtruar të drejtën për njohjen me dosjet e hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni dhe me këtë rast ka nënshkruar aktin “Deklaratë”, datë 07.12.2018, sipas të cilit deklaron se është njohur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij, në formë shkresore dhe digjitale, sipas inventarit përkatës. Nga verifikimi i inventarit të dokumentacionit që i është vënë në dispozicion subjektit, trupi gjykues konstaton se ai është i njëjtë me atë që përmban dokumentacioni i përcjellë nga Komisioni për shqyrtim para Kolegjit, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit. Subjektit i janë vënë në dispozicion raportet e DSIK-së të deklasifikuara pjesërisht, si pjesë e dosjes së hetimit administrativ, përkatësisht: raporti mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 07.02.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së⁴² nr. {***}, datë 25.04.2018 dhe raporti mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 29.10.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 30.10.2018.*
- Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, dërguar në Komision më datë 14.12.2018, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij në lidhje me secilën prej çështjeve të pretenduara prej tij, bazuar në të dhënat e paraqitura në rezultatet e hetimit administrativ, si dhe ka paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e tij. Në këto shpjegime, subjekti nuk ka ngritur asnjë pretendim se i është shkelur e drejta e aksesit për t'u njohur me të gjitha aktet e provat e mbledhura për të, si dhe për t'u ballafaquar me to.*
56. *Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 17.12.2018, ka vendosur të ftojë subjektin në seancë dëgjimore publike dhe e ka njoftuar atë me këtë vendim nëpërmjet postës elektronike. Në verifikim të procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 19.12.2018, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pranuar se është njohur me të gjitha materialet e dosjes së rivlerësimit, pa pretenduar në asnjë moment se i është shkelur e drejta e aksesit për t'u njohur me të gjitha aktet e provat e mbledhura për të, si dhe për t'u ballafaquar me to, si dhe nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për njohjen me ndonjë provë të caktuar. Në përgjigje të kërkesës së kryesuesit të trupit gjykues të Komisionit për qëndrimin përfundimtar në lidhje me procesin e*

⁴¹ *Sipas vendimit nr. 2, datë 04.12.2018, të Komisionit.*

⁴² *KDZh është Komisioni për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin e Informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.*

rivlerësimit ndaj tij, subjekti është shprehur se nga Komisioni i janë respektuar të gjitha të drejtat që parashikon ligji dhe se nuk ka kontestime.

57. Subjekti, në shkakun e ankimit ka pretenduar se atij nuk i janë bërë të njohura të gjitha provat e mbledhura për të, pasi duhet t'i ishin vënë në dispozicion nga Komisioni të gjitha aktet dhe provat e mbledhura nga organet ligjzbatuese, përfshirë edhe ato që përbëjnë sekretet shtetëror, me argumentin se sekretet shtetëror nuk mund të cenohen të drejtën e subjektit për t'u njohur me aktet që e cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se ky është një pretendim i ngritur nga subjekti vetëm në ankim, pasi mbështetur në situatën faktike të analizuar si më sipër, gjatë gjithë hetimit administrativ, subjekti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për njohje me ndonjë provë të posaçme e aq më tepër për njohjen me dokumentacion të klasifikuar "sekret shtetëror". Mosbërja publike e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të rivlerësimit, nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, parashikohet nga fjalια e fundit e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në zbatim të këtij parashikimi, si dhe atij të nenit 16 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar⁴³, DSIK-ja, nëpërmjet KDZh-së ka deklasifikuar atë pjesë të raportit mbi kontrollin e figurës së subjektit, që është çmuar e nevojshme për procesin e rivlerësimit. Informacioni i deklasifikuar i është vënë në dispozicion subjektit dhe ai ka pranuar njohjen me të. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosbërja e njohur subjektit e pjesës së informacionit të klasifikuar, nuk përbën në vetvete një shkelje të të drejtave themelore të tij.
58. Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit të Komisionit, si dhe nga komunikimi i Komisionit me subjektin për vënien në dispozicion të këtyre akteve, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur informacion të mjaftueshëm lidhur me hetimin e kryer nga Komisioni në funksion të procesit të tij të rivlerësimit dhe në funksion të realizimit të së drejtës së tij për t'u mbrojtur. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit është vënë në dijeni jo vetëm për rrethana e fakte që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, por nëpërmjet raporteve të DSIK-së të deklasifikuara pjesërisht dhe rezultateve të hetimit të Komisionit ka marrë dijeni edhe për burimin e informacioneve mbi të cilat janë bazuar konkluzionet e këtij të fundit, të cilat janë organe ligjzbatuese, të ngarkuara nga ligji me kompetencën për dhënien e këtij informacioni. Trupi gjykues vlerëson se subjekti gjatë procesit të rivlerësimit në Komision i janë realizuar garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Këtë qëndrim trupi gjykues e mbështet edhe në jurisprudencën e GjEDNj-së, e cila në çështjen Regner kundër Çekisë, 2017 (Dhoma e Madhe) ka arsyetuar: "E drejta për zbulimin e provave, nuk është një e drejtë absolute gjithashtu. Në rastet penale është gjetur se mund të ketë interesa konkurrues, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët nga rreziku i hakmarrjes ose mbajtja sekrete e metodave të hetimit të krimit nga ana e policisë, të cilat duhet të peshohen mirë ndaj të drejtave të palës tjetër. Megjithatë, vetëm masat që kufizojnë ato të drejta procedurale që nuk ndikojnë thelbin në vetvete të të drejtave materiale, janë të lejueshme sipas

⁴³ Ligji nr. nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar, në nenin 16 "Përfshirjet nga deklasifikimi", parashikon:

"Një informacion mund të përfshihet nga deklasifikimi, kur ekspozimi i tij: a) zbulon identitetin e burimit konfidencial, zbatimin e një metode apo të një burimi informativ; b) nxjerr informacion që dobëson veprimtarinë e kriptologjisë; c) nxjerr informacion që mund të dobësojë planet e ngutshme të sigurimit kombëtar; ç) dëmton një traktat apo marrëveshje ndërkombëtare, marrëdhëniet midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të huaja apo veprimtarinë e mëtejshme diplomatike."

nenit 6, paragrafi 1. Çdo vështirësi që i është shkaktuar palës ankuese nga një kufizim i të drejtave të saj, duhet të balancohet në mënyrë të mjaftueshme nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore”.

59. Subjekti pretendon se Komisioni duhet të kishte kërkuar deklasifikimin edhe të raportit të parë të hartuar nga DSIK-ja, sipas të cilit subjekti ishte konsideruar i përshtatshëm për të ushtruar detyrën. Në analizë të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vendim⁴⁴, Komisioni është shprehur se DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin është konstatuar përshtatshmëria e subjektit, por theksohet fakti se ky raport është hartuar në mungesë të informacionit nga një prej organeve ligjzbatuese. Pas ardhjes së informacionit nga organi ligjzbatues, me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja ka rishikuar raportin për subjektin Admir Belishta dhe në përfundim ka konstatuar papërshtatshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës. Trupi gjykues, bazuar në situatën faktike si më sipër, vlerëson se duke qenë se raporti i parë i hartuar nga DSIK-ja për subjektin e rivlerësimit ka qenë pozitiv, por më pas është rishikuar duke arritur në një konkluzion të ndryshëm, bazuar në informacionet e ardhura nga organet ligjzbatuese, me të drejtë Komisioni nuk e ka vlerësuar këtë raport si relevant për procesin e rivlerësimit, pasi i ka dhënë vlerë provuese raportit të fundit të deklasifikuar pjesërisht nga DSIK-ja, në të cilin subjekti është konstatuar si i papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës, mbështetur në rrethanat e konstatuara në të. Komisioni, kërkesën për deklasifikim të dokumentacionit “sekret shtetëror” për t’ia bërë më pas të njohur këtë dokumentacion subjektit, e ka ushtruar në mënyrë proporcionale, aq sa e ka konsideruar të arsyeshme dhe të nevojshme, në funksion të garantimit të të drejtave të subjektit për t’u njohur me dokumentacionin e hetimit, me qëllim realizimin e së drejtës së tij për t’u mbrojtur, si dhe garantimit të mbrojtjes së sekretit shtetëror, në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar.
60. Subjekti, në këtë shkak ankimi pretendon gjithashtu se në funksion të realizimit të mbrojtjes, për ushtrimin e së drejtës së ankimit i është drejtuar DSIK-së, duke i kërkuar vënien në dispozicion të raportit fillestar, si dhe të akteve dhe provave të grumbulluara për të, por DSIK-ja e ka refuzuar këtë kërkesë, duke i cenuar të drejtat për t’u njohur me aktet e provat e mbledhura në drejtim të tij. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues vlerëson se e shqyrton vendimin e Komisionit lidhur me respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor vetëm për momentet, hapat apo ngjarjet procedurale të përshkruara në këtë vendim, apo dhe të ndërmarra gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Ky pretendim i subjektit lidhet me ngjarje të ndodhura pasi ai është njohur me vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit, si dhe me qëndrimet e mbajtura nga organi ndihmës në procesin e rivlerësimit, konkretisht DSIK-ja. Në këtë proces, DSIK-ja nuk është organ vendimmarrës, por vetëm organ konstatues lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës⁴⁵ dhe deklasifikimi i raporteve apo të dhënave të grumbulluara për subjektet e rivlerësimit bëhet vetëm me kërkesë të Komisionit, për nevojat e procesit të rivlerësimit e në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Por, megjithatë, edhe në analizimin e refuzimit nga DSIK-ja të kërkesës së subjektit, trupi gjykues vlerëson se ky organ ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e

⁴⁴ Shih faqen 30 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.

⁴⁵ Bazuar në nenet 36 e 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar⁴⁶, pasi informacioni i kërkuar nga subjekti është informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”.

61. Subjekti për të provuar këtë pretendim të tij, bashkëlidhur ankimit ka paraqitur këto akte, të cilat ka kërkuar që të administrohen si provë nga Kolegji:

a) kërkesë e subjektit të rivlerësimit Admir Belishta, datë 28.12.2018, drejtuar DSIK-së, me lëndë “Kërkim dokumentacioni”, si dhe kartelat postare të dërgimit të kësaj kërkesë nëpërmjet shërbimit postar;

b) shkresë nr. {***} prot., datë 03.01.2019, e DSIK-së drejtuar z. Admir Belishta, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, e cila ka bashkëlidhur:

b/1) shkresë e DSIK-së me nr. {***} prot., datë 07.02.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***} prot., datë 25.04.2018, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta”, drejtuar Komisionit;

b/2) shkresë e DSIK-së, me nr. {***} prot., datë 29.10.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***} prot., datë 30.10.2018, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta”, drejtuar Komisionit;

b/3) shkresë e DSIK-së me nr. {***} prot., datë 18.12.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***} prot., datë 21.12.2018, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta”, drejtuar Komisionit;

c) kërkesë e subjektit të rivlerësimit Admir Belishta, datë 14.01.2019, drejtuar DSIK-së, me lëndë “Kërkim dokumentacioni”, si dhe kartelat postare të dërgimit të kësaj kërkesë nëpërmjet shërbimit postar;

ç) shkresë nr. {***} prot., datë 18.01.2019, e DSIK-së drejtuar z. Admir Belishta, me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”.

Në lidhje me kërkesën e subjektit për administrimin e këtyre akteve si provë, trupi gjykues vlerëson të mos i pranojë ato, pasi nga verifikimi i akteve të përcjella nga Komisioni në Kolegji, raportet e DSIK-së të paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës bëjnë pjesë në dosjen e rivlerësimit të subjektit. Gjithashtu, bazuar në përcaktimin e nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës duket se është e panevojshme dhe fakti që kërkohet të provohet nga subjekti është i parëndësishëm për vendimmarrjen, në mbështetje të arsytimit të bërë më sipër, në paragrafin 17 të këtij vendimi.

62. Në ankim, subjekti pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, i ka refuzuar kërkesën për ballafaqimin me çdo akt, fakt apo person që ka folur në emër të tij, duke i cenuar kështu të drejtën për të kundërshtuar gjetjet e rezultateve të hetimit si të pavërteta. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton se subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të dërguara në Komision më datë 14.12.2018, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur kërkesën me lëndë “Marrje provash”, në pikën 27 të së cilës ka kërkuar ballafaqimin me të gjithë personat që mund të kenë përmendur apo përdorur emrin e tij në funksion të kontrollit të figurës. Komisioni, me vendimin nr. 04, datë 17.12.2018, ka vendosur të refuzojë këtë kërkesë të subjektit, duke arsyetuar se bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, kjo kërkesë është një mjet prove tërësisht i papërshtatshëm e i paarritshëm. Në seancën dëgjimore në Komision, më datë 19.12.2018, subjekti nuk e ka përsëritur këtë kërkesë. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, bazuar në situatën faktike si më sipër, trupi gjykues

⁴⁶ Bazuar në nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar.

vlerëson se Komisioni e ka shqyrtuar kërkesën e subjektit dhe me vendim të arsyetuar, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e ka rrezuar atë. Këtë arsyetim të Komisionit trupi gjykues e vlerëson të drejtë, pasi në rastin konkret ballafaqimi i kërkuar nga subjekti është i panevojshëm sepse do të duhet të kryhej me organet ligjzbatuese, të cilat në zbatim të ligjit nr. 84/2019 janë shprehur me anë të akteve të cilat i janë bërë të njohura subjektit, pas deklasifikimit pjesërisht të tyre, por gjithashtu mund të rrezikonte edhe sigurinë e burimit të informacionit.

63. Subjekti pretendon gjithashtu se, me refuzimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve, atij i janë shkelur garancitë procedurale të procesit të rregullt ligjor, të parashikuara edhe nga jurisprudenca e GjED-së dhe GjEDNj-së. Trupi gjykues vlerëson se ashtu siç vetë GjEDNj-ja ka pranuar në jurisprudencën e saj, neni 6 i KEDNj-së nuk garanton qartë të drejtën për të thirrur dëshmitarë dhe pranueshmëria e dëshmimeve, në parim, është kompetencë e së drejtës së brendshme. Sidoqoftë, procedura e parashikuar në tërësinë e vet, përfshirë edhe mënyrën se si pranohen dëshmitarët, duhet të jetë e rregullt në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Nën dritën e zbatueshmërisë së parimeve të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së⁴⁷, sipas të cilave nëse dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, gjykatat mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret, Komisioni ka refuzuar në mënyrë të arsyetuar marrjen e provës me dëshmitarë. Për këtë arsye, nuk ka shkelje të parimeve të procesit të rregullt, për sa i përket refuzimit nga Komisioni të kërkesës së subjektit për ballafaqime me personat që mund të kenë përmendur apo përdorur emrin e tij, lidhur me kontrollin e figurës.

Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit se është cenuar në të drejtën për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNj-së, është i pabazuar.

64. *Në lidhje me pretendimin e subjektit se rastet e identifikuar prej tij në mungesë të fakteve konkrete në raportin e DSIK-së dhe Komisionit, për të cilat ka dhënë shpjegime, janë bazuar në treguesit statistikorë të gjykatës dhe jo në hamendësime, siç pretendon Komisioni në vendim dhe se konkluzioni i Komisionit mbi papërshtatshmërinë e subjektit në ushtrimin e detyrës është i pabazuar dhe i paargumetuar, sepse gjatë gjithë procesit të hetimit dhe në seancë dëgjimore nuk iu relatua asnjë fakt, rrethanë, indicie, dokumentacion apo provë konkrete, mbi të cilën bazohet ky konkluzion, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim⁴⁸, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar dhe ka arritur në përfundimin se: Pasi dëgjoi subjektin në seancë, shqyrtoi edhe shpjegimet e tij të paraqitura me shkrim për çështje gjyqësore konkrete, të cilat bazohen mbi hamendësimet e tij nisur nga të dhëna statistikore, shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin, Komisioni vlerëson se raporti i DSIK-së përmban elementet e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i plotë dhe i besueshëm. Në përfundim, Komisioni konkludon për subjektin e rivlerësimit Admir Belishta se është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar. Në arsyetimin dhe vlerësimin e cituar si më sipër, Komisioni, megjithëse ka arritur në përfundimin se subjekti është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, nuk ka përcaktuar se në cilën prej masave disiplinore të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016 rezulton subjekti. Komisioni ka disponuar për masën disiplinore vetëm në dispozitivin e vendimit, duke u shprehur për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016.*

⁴⁷ Shih vendimin nr. 38/2010 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet e GjEDNj-së në çështjet *Dombo Beheer k. Holandës*, 1993 dhe *Wierzbicki k. Polonisë*, 2002.

⁴⁸ Shih faqet 32 dhe 52 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.

Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, duke parë në harmoni dispozitivin e vendimit me arsyetimin dhe konkluzionin e arritur nga Komisioni për kriterin e kontrollit të figurës, konstaton se Komisioni i ka dhënë subjektit masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi ai ka rezultuar ndër të tjera, se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

65. Nga verifikimi i raportit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit nr. {***} prot., datë 29.10.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 30.10.2018, raporti i fundit i DSIK-së i administruar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit⁴⁹ dhe që ia ka bërë të njohur subjektit, trupi gjykues konstaton se ky organ nuk ka përcaktuar që subjekti të ketë bërë deklaram të pasaktë e të pavërtetë në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës. Rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, u përkasin viteve 2007, 2016, mars 2017 dhe nëntor 2017.
66. Trupi gjykues vlerëson se fillimi i procedurës për kontrollin e figurës, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016, referon fillimisht mbi verifikimin e afatit të dorëzimit të deklaramit për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të këtij ligji, dhe më tej mbi verifikimin e saktësisë së saj në përputhje me standardet e plotësimit, sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 38 të këtij ligji. Deklarata për kontrollin e figurës, bazuar në pikën 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, plotësohet për periudhën nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklaramit, duke sanksionuar detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të plotësuar deklaramin me saktësi dhe vërtetësi, vetëm për këtë periudhë. Për sa u përket rrethanave të vitit 2016, në raportin për subjektin e rivlerësimit, DSIK-ja ka shprehur dyshimet se subjekti mund të ketë favorizuar një shtetas të mitur, i gjykuar për veprën penale të vrasjes, si dhe se mund të ketë favorizuar një shtetas, i gjykuar në atë periudhë për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje. Nga verifikimi i shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe akteve që ka paraqitur subjekti bashkëlidhur tyre⁵⁰, lidhur me rastet e referuara nga raporti i DSIK-së, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime dhe ka provuar se shtetasja Sh. M. ka qenë në cilësinë e kallëzueses në një procedim penal ndaj gjyqtarit M. D., si dhe bazuar në evidencat statistikore të gjykatës, subjekti ka evidentuar vendimet gjyqësore të dhëna nga ai në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nga ku rezulton se shtetasit e dyshuar si të favorizuar nga subjekti, sipas raportit të DSIK-së, janë gjykuar dhe dënuar përkatësisht: i pandehuri A. F., deklaruar fajtor dhe dënuar me vendimin nr. {***}, datë 04.02.2016, për veprën penale të vrasjes me dashje sipas nenit 76 të Kodit Penal, si dhe për veprën penale të kanosjes sipas nenit 84 të Kodit Penal; i pandehuri K. B. deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të kontrabandës me mallra të tjera, e parashikuar nga neni 174/1 i Kodit Penal, të pandehurit V. T., M. Z. dhe D. B. deklaruar fajtorë për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal; si dhe i pandehuri K. H. deklaruar fajtor dhe dënuar me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2016, për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, sipas nenit 88/2 të Kodit Penal.

⁴⁹ DSIK-ja ka përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 26.12.2018, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Admir A. Belishta, nr. {***} prot., datë 18.12.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZh-së nr. {***} prot., datë 21.12.2018. Kjo shkresë është protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.01.2019, pas datës së shpalljes së vendimit nr. 93 të Komisionit.

⁵⁰ Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vendimet gjyqësore nr. {***}, datë 04.02.2016 dhe nr. {***}, datë 08.06.2016.

Në mbështetje të rrethanave faktike të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vlerëson se në të tria rastet, dyshimi për favorizim të të pandehurve, i shprehur nga DSIK-ja në raportin për subjektin e rivlerësimit, lidhet me persona që nuk përfshihen në krimin e organizuar sipas përcaktimeve të pikave 6, 8 e 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues vlerëson se standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të këtij neni⁵¹, por Komisioni, në vendim, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit dhe nuk arsyeton mbi asnjë nga parashikimet e nenit 38, pika 6, megjithëse ka arritur më pas në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë standardet e rrethanave që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është plotësuar nga subjekti në mënyrë të plotë dhe të besueshme, të parashikuara nga neni 38, pikat 6 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016.

67. Trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i raporteve të deklasifikuara të DSIK-së për subjektin e rivlerësimit, konstaton se ky organ ndihmës ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit bazuar në nenin 38, pika 4, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: “Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: [...] c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar”. Sipas konstatimeve të DSIK-së, subjekti i rivlerësimit dyshohet se mund të ketë fyer dhe kërcënuar gjyqtarin M. D.; dyshohet se ka favorizuar një shtetas të mitur, i gjykuar për veprën penale të vrasjes, si dhe një shtetas të gjykuar për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje; dyshohet se mund t’i ketë kërkuar një shumë të konsiderueshme parash një shtetasi, për të cilin ka pasur një proces gjyqësor për shpërdorim të detyrës dhe favorizim të kontrabandës. DSIK-ja nuk ka identifikuar në asnjë rast se cili është kontakti i papërshtatshëm, me të cilin subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri, për të mbështetur konstatimin përfundimtar të saj. Komisioni, në vendim, është shprehur se *raporti i DSIK-së përmban elementet e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i plotë dhe i besueshëm.*
68. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të situatës faktike si më sipër në raport me nenet 34 dhe 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016⁵², vlerëson se informacioni i përcjellë nga DSIK-ja në raportet

⁵¹ Neni 38, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “6. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm, janë kur:

“a) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme;

b) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacione të shërbimeve të fshehta dhe të besueshme;

c) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që konstatohet nga informacioni përkatës i besueshëm dhe nga prova të tjera; në rast se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të tjera që janë renditur ose konstatuar sipas këtij paragrafi; në rast se ka prova të tjera për një përfitim, veprim ose pasojë nga kontakti që krijon një dyshim të arsyeshëm se informacioni i marrë është shpjegimi i vetëm i mundshëm”.

⁵² Neni 34 i ligjit nr. 84/2016 përcakton: “Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramive të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.”

Neni 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 parashikojnë: “4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur:

e deklasifikuara për subjektin e rivlerësimit nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, pasi nuk referon në asnjë moment se cilët janë personat e përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët subjekti ka pasur kontakte të tilla që të ketë shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri. Në përputhje me parimin e objektivitetit⁵³, raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit duhet të ishte konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij. Edhe Komisioni, në vendim, nuk ka shpjeguar se cilët kanë qenë personat e përfshirë në krimin e organizuar me të cilët subjekti ka kryer kontaktet e papërshtatshme, si dhe mbi cilat prova ka vërtetuar dyshimet e DSIK-ja se subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme, me të cilët ka shkëmbyer para, dhurata, favore apo pasuri, rrethana këto të cilat e kanë bindur Komisionin për të konsideruar të plotë dhe të besueshëm raportin e DSIK-së për subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë gjithashtu as rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, të parashikuara nga neni 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk është i drejtë.

69. Në lidhje me pretendimin e subjektit se rastet e identifikuar prej tij, në mungesë të fakteve konkrete në raportin e DSIK-së dhe Komisionit, për të cilat ka dhënë shpjegime, janë bazuar në treguesit statistikorë të gjykatës dhe jo në hamendësime, siç pretendon Komisioni në vendim,

a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.

5. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar janë kur:

a) subjekti i rivlerësimit në mënyrë të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas pikës 4, të këtij neni;

b) marrëdhënia familjare e subjektit të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar është e largët, ose ka kontakte familjare të rralla;

c) subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet dhe është distancuar prej tyre. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me kohëzgjatjen e kontakteve ose me perceptimin e arsyeve të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit;

ç) subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni që personi është i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ka qenë në dijeni të faktit se ai do të ishte i pranishëm në një takim, ose është mashtruar për një takim të tillë. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

d) kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;

dh) çdo rrethanë tjetër lehtësuese, e cila parashtrrohet në mënyrë të besueshme nga subjekti i rivlerësimit”.

⁵³ Në përputhje me parashikimin e nenit 38, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

trupi gjykues konstaton se në raportin e DSIK-së të deklasifikuar pjesërisht dhe në rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, subjektit i janë referuar rastet e konstatuara pa emra konkretë personash. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se e vetmja mundësi e tij për të qenë i saktë në identifikimin e çështjeve/rasteve, ishte referimi në treguesit statistikorë të gjykatës, të cilët konsiderohen të dhëna zyrtare.

70. Në ankim, subjekti ka pretenduar se pas dhënies së vendimit nga Komisioni, është vënë në dijeni të disa fakteve të reja në lidhje me shtetasen Sh. M. dhe të ndjerin ish-gjyqtarin M. D. Bashkëlidhur ankimit, subjekti për të provuar pretendimin e tij, se gjyqtari M. D. dhe bashkëshortja e tij, në asnjë rast nuk kanë ngritur pretendime për të, ka paraqitur aktet e mëposhtme, të cilat kërkon që të merren si provë nga Kolegji:
- a) Procesverbal kallëzimi shtesë nr. {***} prot., datë 22.10.2007, me kallëzuese I. D., drejtuar Prokurorisë së Rrethit Korçë dhe Prokurorisë së Rrethit Pogradec ndaj shtetasen Sh. M.
 - b) Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, i Prokurorisë së Rrethit Pogradec, datë 09.11.2007 – deklarimet e shtetasen I. D.
 - c) Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, i Prokurorisë së Rrethit Pogradec, datë 09.11.2007 – deklarimet e shtetasit M. D.
 - ç) Procesverbal mbi kallëzimin e krimit, datë 10.10.2007, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, me kallëzues M. D.
 - d) Procesverbal mbi kallëzimin e krimit, datë 10.10.2007, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, me kallëzuese I. D. ndaj shtetasen Sh. M.
 - dh) Letër ankese e shtetasve M. D. e I. D., drejtuar Gjykatës së Rrethit Pogradec, Prokurorisë së Rrethit Pogradec, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrin të Drejtësisë, Institutit të Mjekësisë Ligjore, Presidentit të Republikës.

71. Në lidhje me kërkesën e subjektit për administrimin e këtyre akteve si provë, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës është e panevojshme dhe fakti që kërkohet të provohet nga subjekti është i parëndësishëm për vendimmarrjen, pasi mbështetur në arsyetimin e bërë më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerësoi se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk është provuar që shtetasja Sh. M., është person i përfshirë në krimin e organizuar.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

D. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

72. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për çdo vendim të marrë në analizë, konkluzioni i Komisionit është i paargumentuar, pasi nuk janë marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit. Konkluzioni i Komisionit bazuar në katër çështjet gjyqësore, është i pabazuar pasi Komisioni nuk mund të shqyrtojë çdo lloj vendimmarrjeje, duke konstestuar çdo lloj arsyeimi, qoftë kur vendimi është cenuar, lënë në fuqi apo kur ndaj vendimit nuk ka pasur fare ankim, duke u kthyer në një shkallë të posaçme gjykimi, jashtë kompetencës së vet kushtetuese dhe ligjore. Subjekti, për dy vendime, është vlerësuar negativisht dy herë, pasi këto vendime janë përdorur nga Komisioni për vlerësimin e figurës dhe për vlerësimin e aftësive profesionale, në kundërshtim me të gjitha parimet e aktet ndërkombëtare. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për çdo vendim*

të marrë në analizë në bazë të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konkluzioni i Komisionit është i paargumentuar, pasi nuk janë marrë në konsideratë shpjegimet e tij, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, ka pasqyruar shpjegimet e dhëna nga subjekti për secilën prej katër çështjeve gjyqësore të hetuara në bazë të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe më tej ka arsyetuar bazuar në vendimet e Gjykatës së Apelit Korçë. Trupi gjykues vlerëson se është kompetencë e Komisionit t'u caktojë shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit vlerën provuese, në përputhje dhe harmoni me të gjitha provat e tjera të mbledhura sipas ligjit.

73. Në ankim, për çështjen e parë të hetuar në bazë të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të cilën është dhënë vendimi nr. {***} i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për të pandehurin A. F., subjekti ka pretenduar se Komisioni në tejkallim të funksioneve të tij, në vendim, u referohet përgjegjësi administrative të tij si drejtues i kësaj gjykate dhe jo si gjyqtar. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se përgjegjësitë që i janë ngarkuar nga Komisioni nuk ekzistojnë realisht, sepse titullari nuk mund të kontrollojë çdo veprim të kryesekretarisë së gjykatës, pasi këtë gjë e bën fillimisht kancelari. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues, nga aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, konstaton se vendimi nr. {***}, datë 04.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është kundërshtuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe nga të afërmit e viktimës pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Kjo dosje, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.2016, është dërguar nga ana e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Korçë për në Gjykatën e Apelit Korçë.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {***}, datë 10.11.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga Prokuroria Korçë si jashtë afatit ligjor dhe të shtetasit M. K. si ankim i bërë nga një person i palegjitimuar, duke arsyetuar se: “Duke iu referuar këtyre të dhënave, Gjykata e Apelit krijon bindjen se ankimi i prokurorisë, pavarësisht dërgimit të tij nga ana e këtij institucioni më datë 12.02.2016, nuk është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Korçë as në datën e paraqitjes së tij, as deri në datën 16.02.2016 kur vendimi për të pandehurin A. F. është lëshuar nga kancelaria e gjykatës me shënimin se ka marrë formë të prerë (datë 15.02.2016). Fakti që vendimi ka marrë formë të prerë dhe nuk është ushtruar ankim nga ana e Prokurorisë është verifikuar dhe nga prokurori i ekzekutimit të vendimeve penale në momentin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr. {***}, bashkangjitur të cilit ndodhet kopja e vendimit të gjykatës me shënimin “ka marrë formë të prerë”. Veprimet e mëvonshme procedurale të komunikimit të ankimit, i cili është kryer në datën 22.04.2016, shumë më vonë si nga data e dorëzimit të ankimit nga ana e prokurorit, ashtu dhe shumë kohë pas kalimit të afatit 10-ditor që parashikon neni 419 i K.Pr.Penale për dërgimin e akteve të procedimit dhe ankimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Gjykatën e Apelit, nuk mund të konsiderohen si të kryera brenda afateve ligjore për paraqitjen e ankimit, qoftë dhe duke pasur justifikim veprimet e gabuara dhe ngatërresën e gjykatës dhe, në këto rrethana, duke e konsideruar si jashtë afatit ligjor, ankimi i prokurorisë nuk mund të pranohet.

Para marrjes së këtij vendimi, ka pasur një komunikim shkresor ndërmjet Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kjo e fundit, nëpërmjet kryetarit të saj Admir Belishta (subjekti i rivlerësimit), me shkresën nr. {***} prot., datë 06.10.2016, i ka kthyer përgjigje Gjykatës së Apelit Korçë, duke e vënë në dijeni se ankimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë është depozituar pranë kësaj gjykate më datë 12.02.2016, por për shkak të një ngatërrese në sekretarinë e gjykatës, për të cilën u është tërhequr vëmendja personave përgjegjës, ankimi nuk ka marrë numër rendor në vijimësi, por është vendosur me fraksion, siç pasqyrohet edhe në librin e depozitimit të ankimeve.

Nga kopja e librit të regjistrimit të ankimeve, përcjellë në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, trupi gjykues konstaton se ky ankim është i regjistruar me numër rendor {***}, por ky numër nuk ndjek rendin normal të regjistrimeve në protokoll, pasi nuk lidhet me ankimin që ka numrin rendor {***}, i cili është ankim për një vendim tjetër gjyqësor.

Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i depozituar në këtë dosje, në fund të tij, rezulton vula e vendosur nga sekretaria dhe kancelari i kësaj gjykate me shënimin: “Vendimi mori formë të prerë në datë 15.02.2016, Korçë, më datë 16.02.2016”. Në këtë dosje gjyqësore ndodhet i depozituar edhe urdhri nr. {***}, datë 16.02.2016, i Prokurorisë së Rrethit Korçë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe caktimin e të dënuarit A. F. të vuajë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimit Penal, {***}.

74. Në analizë të legjislacionit të zbatueshëm në këtë rast, trupi gjykues vlerëson se neni 42, pika 1⁵⁴ e ligjit nr. 84/2016 referon në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), për sa u përket burimeve për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ligji nr. 96/2016, në seksionin II, nenet 79-83, parashikon kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit. Subjekti i rivlerësimit, sipas të dhënave të formularit të vetëvlerësimit profesional dhe raportit të KLD-së, ka ushtruar detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nga prilli 2007 e në vijim. Neni 82 i ligjit nr. 96/2016, si një nga burimet për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit, në shkronjën “ç” parashikon: “ç) çdo urdhër ose vendim i kryetarit, i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e gjyqtarëve ose prokurorëve ose të administratës gjyqësore ose të prokurorisë”. Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁵⁵ në përcaktimin e kompetencave të kryetarit të gjykatës, konkretisht në nenin 18, pika 3, shkronja “g” parashikon se kryetari kryen detyra në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi. Po ky ligj në nenin 37, pika 1 përcakton se kancelari i gjykatës drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë, të cilat sipas nenit 39 të po këtij ligji kryhen nga administrata gjyqësore, e përbërë nga sekretaria gjyqësore, si dhe degët dhe sektorët e tjerë të administratës. Në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e ndryshuar, e miratuar me urdhrin nr. {***} prot., datë 05.10.2010, të kryetarit të saj, subjektit të rivlerësimit Admir Belishta, e aksesueshme në faqen zyrtare në internet të kësaj gjykate⁵⁶, në nenin 19, paragrafi 3 i saj parashikohet se për shkeljet disiplinore, punonjësit e administratës ndëshkohen me masa disiplinore, me vendim me shkrim të motivuar dhe të arsyetuar të titullarit të gjykatës.

75. Në verifikimin e zbatimit të këtyre dispozitave në rastin konkret, në raport me situatën faktike të analizuar më sipër në këtë vendim⁵⁷, trupi gjykues vlerëson se administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka përmbushur me korrektësi detyrën funksionale. Komisioni, në arsyetimin e tij, ka vlerësuar veprimet e subjektit në cilësinë e kryetarit, në përmbushje të kompetencave që i ka njohur ligji, për rastin konkret. Subjekti ka pretenduar se veprimi i administratës gjyqësore ka qenë një gabim njerëzor, por gjithashtu ka pretenduar se kryesekretares i është tërhequr vërejtja dhe më vonë ka shkëputur marrëdhëniet me gjykatën, por

⁵⁴ Neni 41, pika 1, fjalia e parë e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

⁵⁵ Ligji i kohës.

⁵⁶ <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-korce/gjykata-e-rrethit-korce/rregullore-te-gjykatës/>.

⁵⁷ Shih paragrafin 32 të këtij vendimi.

nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se ai nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë marrjen e masave ndaj administratës gjyqësore, në kuptim të legjislacionit në fuqi apo se shkëputja e marrëdhënieve të punës së kryesekretares ka ndodhur si rezultat i një mase disiplinore për shkak të kësaj ngjarjeje. Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë se ka marrë të gjitha masat që i ngarkonte ligji, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, për rastin konkret. Ndërhyrja në regjistrin e depozitimit të ankimeve të kësaj gjykate nuk mund të vlerësohet në mënyrë individuale nga kryetari i gjykatës si një gabim njerëzor, pa kryer një hetim administrativ për të zbuluar arsyet e kryerjes së këtij veprimi, si rezultat i të cilit organi i akuzës ka humbur të drejtën kushtetuese të ankimit. Madje, me cilësinë e kryetarit të kësaj gjykate, subjekti do të duhej të kishte marrë masa konkrete duke referuar rastin në organin kompetent, për të vërtetuar nëse ishte rasti i një gabimi njerëzor apo falsifikimi të fletës së regjistrit. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, duke konsideruar edhe faktin se Komisioni hetimin për këtë çështje e ka nisur mbi bazën e informacioneve të disponuara për etikën dhe aftësitë profesionale, sipas nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti me veprimet dhe mosveprimet e tij, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

76. Në lidhje me pretendimin e subjektit, në ankim, se konkluzioni i Komisionit i mbështetur në analizën vetëm për katër çështjet gjyqësore, është i pabazuar pasi Komisioni nuk mund të shqyrtojë çdo lloj vendimmarrjeje, duke kontestuar çdo lloj arsytimi, qoftë kur vendimi është cenuar, lënë në fuqi apo kur ndaj vendimit nuk ka pasur fare ankim, duke u kthyer në një shkallë të posaçme gjykimi, jashtë kompetencës së vet kushtetuese dhe ligjore, trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i procedurës së ndjekur në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, konstaton se Komisioni, për vlerësimin e katër dosjeve të hetuara sipas nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka kërkuar kryerjen e analizës nga organi ndihmës KLD, megjithëse në nenin E të Aneksit të Kushtetutës⁵⁸ dhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, theksohet rëndësia e ndihmës që japin organet e specializuara në kryerjen e procesit të rivlerësimit, në përputhje me frymën e Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
77. Trupi gjykues konstaton, gjithashtu, se përfundimet e arritura nga Komisioni, për secilën prej tri çështjeve gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç është shprehur në vendim⁵⁹, kanë të bëjnë me mënyrën jokorrekte të vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimin jo të plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore nga subjekti i rivlerësimit, konstatime këto edhe të gjykatave më të larta. Konkretisht, në lidhje me çështjen gjyqësore me të pandehur L. K. dhe çështjen gjyqësore me të pandehur K. B. dhe të tjerë, konstatohet se Komisioni e ka mbështetur vlerësimin e tij në të njëjtat argumente që ka përdorur Gjykata e Apelit Korçë në vendimet e saj, në të cilat ka disponuar për prishjen e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ndërsa në çështjen me të pandehur K. H., Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë interpretim të gabuar të ligjit penal, duke çmuar se subjekti nuk ka bërë vlerësimin e duhur të fakteve dhe provave. Në analizë të përfundimit të

⁵⁸ Neni E i Aneksit të Kushtetutës, në pikën 2, parashikon: “2. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi. Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj [...]. Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.”

⁵⁹ Shih faqen 52 të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit.

sipërcituar të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit, duke zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e tij në vlerësimin e provave dhe ligjit, në ndryshim nga sa parashikon standardi ligjor për vlerësimin e gjyqtarit, i vendosur në nenin 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, e cila parashikon: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

78. Në lidhje me pretendimin e subjektit në ankim, se për dy vendime është vlerësuar negativisht dy herë, pasi këto vendime janë përdorur nga Komisioni për vlerësimin e figurës dhe për vlerësimin e aftësive profesionale, në kundërshtim me të gjitha parimet e aktet ndërkombëtare, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka shpjeguar se për cilat parime dhe akte ndërkombëtare bëhet fjalë, por nisur nga përmbajtja e këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson ta shqyrtojë atë si të lidhur me parimin *ne bis in idem*, i cili megjithëse është një parim i zbatuar kryesisht në fushën e së drejtës penale, nëse do të shtrihet edhe në proceset disiplinore, atëherë do të interpretohej si moslejim i dhënies së dy masave disiplinore, bazuar në të njëjtat fakte dhe sjellje.
79. Duke iu kthyer çështjes konkrete, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, ka arritur në përfundimin se raporti i DSIK-së përmban elementet e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i plotë dhe i besueshëm, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti ka dhënë shpjegime, ndër të tjera edhe për çështjen me të pandehur të miturin A. F., si dhe për çështjen me të pandehur K. B. e të tjerë. Komisioni, për këto çështje, i ka kaluar subjektit barrën e provës edhe për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale. Për çështjen me të pandehur K. B. e të tjerë, e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Komisioni, në analizën e kriterit të kontrollit të figurës ka arsyetuar se konstatimi i DSIK-së se subjekti ka favorizuar të pandehurit, është i drejtë, ndërsa në analizën e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale arsyeton të kundërtën, se subjekti ka dhënë një vendim të pabazuar, duke i dënuar të pandehurit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të kryer në bashkëpunim. Komisioni, në vendim, megjithëse në përfundim të arsyetimit për vlerësimin e aftësive profesionale shprehet se *të metat e konstatuara në shqyrtimin e katër dosjeve gjyqësore reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, konstatime këto edhe të gjykatave më të larta*, në vijim, në konkluzionet përfundimtare nuk konkludon në lidhje me këtë kriter. Masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, Komisioni e ka marrë në bazë të nenit 61, pikat 3 dhe 5. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se për dy vendime është vlerësuar negativisht dy herë nga Komisioni, nuk është i bazuar.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

80. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në shkaqet e ankimit, parashtrimet e paraqitura prej tij, me shkrim, 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, si dhe të gjitha provat e aktet e administruara nga Komisioni

gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, arriti në konkluzionin se vendimi nr. 93, datë 21.12.2018, i Komisionit është i drejtë, pasi:

80.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

1. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 107 m², e regjistruar në ZK {***} Korçë, me nr. pasurie {***}, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

2. Për pasurinë shtëpi me sipërfaqe prej 62,4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 130,03 m² në fshatin {***}, Maliq, Korçë, e legalizuar me lejen e legalizimit nr. {***}, datë 26.12.2014, e regjistruar në ZVRPP Korçë, subjekti i rivlerësimit:

a) nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me mënyrën e përfitimit të truallit prej 470 m², në të cilin ka ndërtuar këtë shtëpi, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016;

c) nuk ka kryer deklaramin e shpenzimeve të kryera për këtë ndërtim në vitin 2013 kur ndërtimi ka përfunduar, si dhe detyrimet ndaj të tretëve, por i ka deklaruar në vitin 2014, kur ka kryer edhe procedurat për legalizimin e këtij ndërtimi, duke qenë në kushtet e deklaramit të pasaktë të pasurisë në deklaratën e pasurisë së vitit 2013, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

3. Për pasurinë automjet “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2002, në pronësi të tij, subjekti i rivlerësimit:

a) nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti, siç parashikohet në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

4. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese të pasurisë së paluajtshme të bashkëshortes në tokë bujqësore, truall dhe banesë në fshatin {***}, Devoll, as në deklaratën e pasurisë në rivlerësimit, as në deklaratën e pasurisë së vitit 2013, vit në të cilin bashkëshortja është bërë person i lidhur me subjektin për shkak të martesës, duke kryer deklaram të pasaktë të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

5. Nga analiza financiare e kryer nga trupi gjykues në shqyrtim të shkaqeve të ankimit në raport me konkluzionet e nxjerra nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet e kryera në periudhën 2011-2014, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke konsideruar në tërësi konkluzionet si më sipër, e vlerëson të drejtë përfundimin e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

80.2 Për kriterin e kontrollit të figurës

Trupi gjykues, pasi analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim dhe arsyetimin e Komisionit në lidhje me këtë kriter vlerësimi, arriti në konkluzionin se gjatë gjykimit u provua se rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë kriteret e rrethanave që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është plotësuar nga subjekti në mënyrë të plotë dhe të besueshme, të parashikuara nga neni 38, pikat 6 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016. Rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë gjithashtu as rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, të parashikuara nga neni 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e për këtë arsye e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se nuk ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

80.3 Trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionin për sa i përket përfundimit të arritur pas vlerësimit tërësor, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, se subjekti i rivlerësimit:

a) me tërësinë e veprimeve të tij, me kryerjen e ndërtimit të shtëpisë dykatëshe me sipërfaqe 62,4 m² e sipërfaqe totale ndërtimi 130,03 m² në fshatin {***}, Maliq Korçë, në vitin 2013, në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi; si dhe

b) në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, me mosmarrjen e masave për funksionimin e administratës gjyqësore, në lidhje me regjistrimin e ankimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kundër një vendimi gjyqësor, si pasojë e të cilit organi i akuzës ka humbur të drejtën e ankimit;

ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këtë shkak, ai duhet të konsiderohet i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës në përputhje me parashikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

- 81.** Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
- 82.** Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha akteve e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit, bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Admir Belishta ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në përputhje me parashikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
- 83.** Trupi gjykues, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, vlerëson se vendimi nr. 93, datë 21.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 93, datë 21.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Belishta.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.01.2020.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi